Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë nga 10 deri më 12 shkurt 2018 në Qendrën për kuadro dhe rekreacion të Kryqit të kuq "Solferino" në Strugë zh-

villoi një seminar për ndërtimin e ekipit. Qëllimi i ndërtimit të ekipit ishte ndërtimi i një ekipi më të mirë dhe koheziv, i cili mund të funksionojë si një i vetëm gjatë kryerjes së detyrave të përditshme dhe gjatë punës nën presion, bashkëpunimi më i mirë dhe zhvillimi i frymës ekipore midis anëtarëve të ekipit dhe ngritja e nivelit të motivimit. Punëtorja treditore përbëhej nga aktivitete të ndryshme re-kreative, zbavitëse dhe sugjerime për përmirësimin e komunikimit me kapacitetet potenciale dhe ekzistuese. Ushtrimi përfundoi me rezultatet e pritshme dhe aktivitetet e ardhshme të zhvillimit të Kryqit të kuq në përputhje me misionin, vizionin dhe qëllimet që i synon Kryqi i kuq.





Vizita bilaterale (dypalëshe) në Shqipëri

Në periudhën 21-23 shkurt të vitit 2018, një delegacion tre-anëtarësh i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë bëri një vizitë bilaterale në Kryqin e kuq të Shqipërisë në Tiranë. U vizitua Zyra qendrore dhe Zyra e Kryqit të kuq të Tiranës. U diskutua bashkëpunimi i ndërsjellë me theks në programet e dhurimit të gjakut, gatishmërinë dhe veprimin në fatkeqësi, programet sociale dhe ndihmën e parë, si dhe aktivitetet për sigurimin e mbështetjes për të moshuarit. U ra dakord për vizitën e një delegacioni të Kryqit të kuq të Shqipërisë në Maqedoni për të nënshkruar një marrëveshje kornizë të bashkëpunimit për vitin 2018.

Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore

Në periudhën nga 23 deri më 25 shkurt, Shoqata nacionale organizoi një punëtori për menaxhimin e burimeve njerëzore për sekretarët e KKRMs-së. Trajnimi u realizua në bashkëpunim me Shtëpinë këshilluese "Detra" dhe Shoqatat nacionale të vendeve fqinje, Kryqi i kuq i Serbisë dhe Kryqi i kuq i Bullgarisë (23-25 shkurt). Qëllimi i trajnimit ishte rritja e shkathësisë dhe kompetencave të organizatave komunale të Kryqit të kuq me theks në punën me vullnetarët.

Takimi koordinues me sekretarët e OKKK-ve

Më 24 prill të vitit 2018 në lokalet e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë u mbajt një takim koordinues me sekretarët e organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Puna u zhvillua në dy pjesë. Në pjesën e parë të takimit, sekretarët e organizatave komunale

të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit diskutuan zgjidhjet e reja softuerike që kanë për qëllim të bëjnë më të suksesshme punën e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në periudhën e ardhshme. Në pjesën e dytë u diskutua Rregullorja e metodologjisë për përcaktimin e vendeve të punës dhe llogaritjen e rrogave në Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë.

U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit me Kryqin e kuq të Shqipërisë

Më 25 prill një delegacion katër-anëtarësh i Kryqit të kuq të Shqipërisë, i kryesuar nga kryetari Ylli Alushi, vizitoi Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë. Gjatë kohës së vizitës u bë fjalë për thellimin e bashkëpunimit të të dyja shoqatave nacionale në nivelin nacional dhe lokal. Gjithashtu u nënshkrua platforma e bashkëpunimit në veprimtaritë e ndryshme programore të dy shoqatave nacionale. Dy shoqatat nacionale kanë nënshkruar një marrëveshje për bashkëpunim bilateral në vitin 1998. Gjatë kohës së qëndrimit gjithashtu u vizitua Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit dhe organizata komunale e Kryqit të kuq – Çair, ku u prezantuan aktivitetet programore të shoqatës nacionale në nivel lokal. Mysafirët vizituan edhe Qendrën ditore për dhurimin e gjakut, Qendrën ditore për të moshuarit, Qendrën e të pastrehëve dhe Qendrën Logjistike të KKRMs-së.

Konferenca e 10-të Rajonale e Evropës e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe

Në periudhën 2-4 maj të vitit 2018 në Almati, Kazakistan, u mbajt Konferenca e 10-të Rajonale e Evropës e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë u prezantua me një delegacion dy-anëtarësh. Në këtë konferencë u shqyrtuan shumë çështje evropiane në lidhje me punën e Lëvizjes në Rajon. U miratua raporti i Konferencës së 9-të Rajonale të Evropës së shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, e mbajtur në Firencë, Itali, në vitin 2014. Gjithashtu u shqyrtua dhe u miratua deklarata e Takimit të Të Rinjve të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, i mbajtur në Bishek, Kirgistan në periudhën nga 28 deri më 30 prill të vitit 2018. Në këtë konferencë gjithashtu u paraqit raporti për trendët e ardhshëm në Evropë në bazë të takimit konsultativ të shoqatave të Evropës në lidhje me përgatitjen e Strategjisë 2030 të Federatës ndërkombëtare. Në sesionet plenare u diskutua rreth tri pikave: Qëndrueshmëria në punën e shoqatave nacionale; Koordinimi dhe bashkëpunimi në Lëvizjen në Evropë dhe në Azinë Qendrore; dhe Migrimet.

Vizita e Kryqit të kuq në Serbi

Në periudhën nga 11 deri më 13 maj të vitit 2018, një delegacion i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë i përbërë nga përfaqësues të këshillit udhëheqës dhe shërbimit profesional të Shoqatës nacionale realizoi një vizitë pune në Kryqin e kuq të Serbisë. Gjatë vizitës u realizua një takim në selinë e Kryqit të kuq të Serbisë në Beograd, ku u theksua bashkëpunimi i mirë dhe iniciativa për nënshkrimin e platformës së bashkëpunimit me një plan operativ midis dy shoqatave nacionale. Theks i veçantë u vu në ngritjen e kornizës statutore dhe normative të dy shoqatave nacionale, në programet e dhurimit të gjakut dhe sfidat në lidhje me zbatimin e trajnimeve të ndihmës së parë, pozicionimin strukturor të organizatave në nivelin lokal, dhe burimet e financimit. Gjatë vizitës u vizitua Kryqi i kuq i Novi Sadit dhe Organizata komunale e Kryqit të kuq të Zrenjaninit.

Pjesëmarrja në sesionin e 66-të të Kuvendit të përgjithshëm të Kryqit të kuq të Bullgarisë

Në periudhën 25-26 maj të vitit 2018, Sekretari i përgjithshëm i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, Dr. Sait Saiti mori pjesë në sesionin e 66-të të Kuvendit të përgjithshëm të Kryqit të kuq të Bullgarisë. U theksua bashkëpunimi në mes dy shoqatave nacionale që u bë zyrtar kohët e fundit me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit i shoqëruar me një plan operativ të veprimit i cili rregullon bashkëpunimin bilateral për çdo vit.

Vizita e Kryqit të kuq në Kroaci

Në periudhën 24-26 korrik të vitit 2018 Sekretari i përgjithshëm i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë vizitoi Kryqin e kuq të Kroacisë në Zagreb. Gjatë vizitës u realizuan takime me menaxhmentin dhe udhëheqjen e Kryqit të kuq të Kroacisë, ku u diskutuan shumë çështje me interes për bashkëpunimin bilateral midis dy shoqatave nacionale, me theks në financimin e organizatave dhe implementimin e programit të migruesve, programin e gatishmërisë dhe veprimit në katastrofa, programin social dhe shëndetësor dhe bashkëpunimin e dy shoqatave nacionale në kuadër të Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Takimi rajonal për migruesit

Organizuar nga Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, në Mal të Zi, më 31 gusht të vitit 2018 në Budva u mbajt një takim pune i personave përgjegjës për migrimet nga Zyra e Zonës Evropiane të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe nga Budapesti dhe përfaqësues të shoqatave nacionale të Rajonit. Kryqi



i kuq i Republikës së Maqedonisë u përfaqësua nga udhëheqësi i sektorit të programeve, Sasho Taleski dhe koordinuesi i gatishmërisë dhe veprimit në katastrofa, Ali Samet. Qëllimi i takimit të punës ishte shkëmbimi i praktikave dhe përvojave të shoqatave nacionale të Rajonit në lidhje me situatat aktuale me krizën e migruesve, si dhe përgatitja e një plani operativ për mbështetjen e migruesve për vitin 2019. Në takimin e punës përfaqësuesit e shoqatave nacionale paraqitën situatën me migruesit gjatë viteve të fundit, që nga fillimi i krizës së migruesve në vitin 2014 e deri më sot, situatën momentale dhe aktivitetet në qendrat e pritjes në rajon, si dhe çështjen e migracionit të parregullt dhe trendët dhe parashikimet në lidhje me numrin e migruesve që priten në vitin 2019 dhe kornizën e nevojshme financiare për të përmbushur nevojat themelore të migruesve.

Vizita e ambasadorit të Republikës së Shqipërisë

Më 08 tetor të vitit 2018, Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë e vizitoi ambasadori i Shqipërisë në Republikën e Maqedonisë, z. Fatos Reka. Sekretari i përgjithshëm i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, z. Sait Saiti e informoi ambasadorin me aktivitetet kryesore të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë që janë duke u realizuar në planin vendor dhe ndërkombëtar.

Vizita e përfaqësuesve të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Kryqit të kuq të Italisë

Në periudhën nga 6 deri më 9 nëntor të vitit 2018, Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë e vizitoi shefja e rajonit për Ballkanin e Federatës ndërkombëtare, Seija Turninoska dhe shefi i Zyrës rajonale të Kryqit të kuq të Italisë në Malin e Zi, Flavio Çiriaci. U realizuan takime me Sekretarin e përgjithshëm, shërbimin në KCRM dhe Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit. U prezantuan aktivitetet e Shoqatës nacionale. U realizuan vizita në terren për të prezantuar aktivitetet e KCRM-së. U diskutuan mundësitë e financimit të aktiviteteve të caktuara programore në vitin 2019.

Vizita e delegacionit të Kryqit të kuq të Bullgarisë

Në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar të bashkëpunimit midis Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Kryqit të kuq të Bullgarisë u realizua një vizitë e një delegacioni të Kryqit të kuq të Bullgarisë në Republikën e Maqedonisë në periudhën nga 21 deri më 24 nëntor të vitit 2018. Ky delegacion vizitoi Zyrën qendrore të KKRМ-së dhe aty u diskutua për bashkëpunimin bilateral të dy organizatave. Delegacioni i KKB-së i kryesuar nga akademik Hristo Grigorov dhe drejtorja e përgjithshme Dr. Sofija Stojmenova, realizoi një takim tek Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, z-ja Milla Caroska. Më 23 nëntor u mbajt një sesion i përbashkët i këshillave udhëheqës të dy shoqatave nacionale. Në këtë sesion u prezantuan arritjet kryesore të dy shoqatave nacionale në vitin 2018 të realizuara në planin nacional dhe ndërkombëtar. Gjithashtu u miratua raporti për realizimin e Planit Vjetor të Bashkëpunimit midis Kryqit të kuq të Bullgarisë dhe Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në vitin 2018 në kuadër të fushave në vijim: shpëtimi në mal, siguria në ujë, gatishmëria dhe veprimi në katastrofa, ndi-

hma e parë, veprimtaria sociale humanitare, zhvillimi organizativ, dhurimi i gjakut, pjesëmarrja në nisma të përbashkëta shumëpalëshe, bashkëpunimi ndërkomunal dhe Kryqi i kuq rinor. Në sesionin e punës u miratua plani dyvjeçar i bashkëpunimit për periudhën e viteve 2019-2020.

Takimi i sekretarëve të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit

Më 13 dhjetor në Shkup u mbajt një takim koordinues me sekretarët e organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Në këtë takim koordinues u diskutuan çështjet aktuale në lidhje me punën e Shoqatës nacionale siç janë procedura për miratimin e Ligjit të ri të Kryqit të kuq të RM-së, përgatitja e Strategjisë së re Zhvillimore të Shoqatës nacionale për periudhën 2020-2030, çështjet në lidhje me dhurimin e gjakut dhe gatishmërinë dhe veprimin në katastrofa, zbatimimi i aktiviteteve rinore dhe i projekteve aktuale që janë duke u zbatuar nga ana e Shoqatës nacionale.



TRANSPARENTË, LLOGARIDHËNËS DHE NË DISPOZICION PËR PUBLIKUN

Informimi në vitin 2018 kontribuoi për themelimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të komunikimit dhe informimit për një bashkëpunim më të afërt midis Kryqit të kuq dhe mjetet e informimit. Në suaza të sistemit informativ, Kryqi i kuq ka siguruar një informim më të gjerë për publikun me qëllim të njoftimit të vazhdueshëm të qytetarëve me aktivitetet tona. Si metodë e punës së suksesshme kemi përdorur mënyra moderne të informimit duke arritur që të tërheqim vëmendjen e publikut. Komunikimi i jashtëm është realizuar përmes kumtesave dhe informacioneve të ndryshme për mediat elektronike dhe të shtypura, nëpërmjet organizimit të konferencave të shtypit, brifingjeve etj.

Rrjetet sociale të KCRM-së

Përmirësimi i faqes së Facebook-ut, Instagram-it dhe ridizajnimi i faqes së internetit të KCRM-së lejon hapësirë për shpalljen e një numri më të madh të informacioneve të shumëllojshme të cilat kanë një strukturë për të targetuar kategori të ndryshme të vizitorëve. Pasurimi i tillë i ueb-faqes me një përmbajtje të pazakontë dhe ndërvepruese kontribuoi për një atraktivitet dhe vizitueshmëri më të madhe të saj nga të gjitha strukturat e qytetarëve. www.redcross.org.mk për herë të tretë u shpall "Sajti i vitit" në kategorinë e sektorit joqeveritar, organizuar nga ana e Media Solutions. Vullnetarët dhe qytetarët e tjerë vizitojnë faqet për të ardhur tek informacionet për ngjarjet, vendet e dhurimit, e madje edhe për mënyrën e përfshirjes në Organizatë dhe për aktivitetet e saja.

E-gazeta Info

Botimet javore të gazetës elektronike të Kryqit të kuq tanimë dhjetë vjet janë një shembull i një vegle të suksesshme të informimit të vullnetarëve, partnerëve, bashkëpunëtorëve dhe mbështetësve tanë për aktivitetet që i realizojmë në nivelin lokal, nacional dhe ndërkombëtar. Në vitin 2018 janë përgatitur 93 numra të E-gazetës Info me gjithsej 934 tekste të botuara. Përveç dërgimit të 81 264 adresave të emailit, është bërë rregullisht përditësimi i saj dhe ajo është botuar në ueb-faqen tonë duke i mundësuar gjithë publikut në Republikën e Maqedonisë të njihet më afër me aktivitetet tona.

Bashkëpunimi me mediat

Edhe në vitin 2018 ishte në drejtim të diseminimit të aktiviteteve të Kryqit të kuq tek mediat dhe sigurimi i mbështetjes mediatike për aktivitetet tona.

Punëtorja me mediat

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë më 22 tetor të vitit 2018 organizoi një punëtori me përfaqësuesit e mediave. Punëtorja u mbajt me mbështetjen e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq me qëllim të përparimit të bashkëpunimit me mediat dhe për të ndarë informacionet në lidhje me informimin dhe komunikimin në situata të krizës.



Në punëtori u prezantuan aspektet e ndryshme të lidhura me funksionimin e Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe mandatin e komponentëve të Lëvizjes, veçanërisht me aktivitetet e informimit dhe komunikimit në kohë dhe korrekt në situata krize, me sistemin për sigurimin e asistencës humanitare dhe ofrimin e shërbimeve për personat në rrezik në situatat emergjente dhe mekanizmat dhe instrumentet në dispozicion për ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, si organizata më e madhe humanitare në vendin tonë, prezantoi përvojat e periudhës së kaluar të lidhura me ballafaqimin me situatat e krizës në Republikën e Maqedonisë si rezultat i katastrofave natyrore dhe lëvizjes së popullsisë. Punëtorja e dytë me përfaqësues të mediave në bashkëpunim me Shoqatën "Humanost" u mbajt më 19 nëntor të vitit 2018 me qëllim të informimit të tyre me temat me rëndësi për të moshuarit, tema që janë përfshirë përmes anëtareve të rrjetit "InkluzivaM" dhe që janë në kuadër të Projektit rajonal "Marrja e aktiviteteve për përfshirjen sociale të personave të moshuar", financuar nga Bashkimi Evropian dhe mbështetur financiarisht

nga Kryqi i kuq i Austrisë dhe Agjencia Austriake e Zhvillimit.

Publikimet

Javët tradicionale të përcaktuara në Ligjin e Kryqit të kuq, si dhe një numër i madh aktiviteteve të projekteve dhe dokumentesh strategjike në kuadër të veprimtarisë botuese të Shoqatës nacionale, edhe këtë vit u plotësuan rregullisht me materiale arsimore kreative dhe atraktive në formën e broshurave, flajerëve, posterëve, doracakëve, pullave me pagesë shtesë dhe lloje tjera botimesh. Duke pasur në vete mesazhet humanitare ose drejtimet e veprimit, u shënuan rezultate të rëndësishme tek grupet e synuara dhe në të njëjtën kohë kjo ndikoi në rritjen e imazhit të Shoqatës nacionale. Për t'i bërë më afër për personat për të cilët janë dedikuar, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë publikoi të gjitha botimet e tij në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe, dhe disa prej tyre u përkthyen në gjuhën angleze.

DISEMINIMI

Aktivitetet e diseminimit në vitin 2018 u orientuan drejt përhapjes së njohurive rreth Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, përmirësimit të sistemit për kryerjen e një diseminimi të përgjithshëm dhe diseminimin e DHN-së. Më poshtë është një pasqyrë e shkurtër e aktiviteteve të diseminimit që shënuan vitin kalendarik.

8 Maji – Dita Botërore e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe

Kryqi i kuq tradicionalisht shënon Ditën Botërore të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, 8 majin, me moton "Gjithkund për secilin". Ngjarja qendrore u mbajt në sheshin e qytetit të Shkupit dhe si pjesë e aktiviteteve u realizua loja paraolimpike "Boçia" dedikuar personave me aftësi të kufizuara. Si pjesë-marrës u përfshinë personat e qendrave ditore për personat me aftësi të kufizuara nga Shkupi, Velesi, Kavari, Dibra, Dellçeva, Kërçova, Gostivari dhe Prilepi, dhe për të mbështetur promovimin e mundësive të barabarta dhe rritjen e ndërgjegjes publike për personat me aftësi të kufizuara, ngjarjes iu bashkuan edhe vullnetarët e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe të organizatave komunale të territorit të qytetit të Shkupit.

Gjithashtu në lojën paraolimpike aktivisht u përfshinë nxënësit e 10 shkollave të mesme të territorit të qytetit të Shkupit, në të cilat është duke u realizuar projekti "Klubet shkollore të edukimit dhe parandalimit të Kryqit të kuq". Nxënësit dhe profesorët e tyre përgjegjës kontribuan në realizimin më të lehtë të lojës, në ndihmën dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu u promovua pulla postare me rastin e 8 Majit.



Shënimi i 26-vjetorit të pavarësimit të Shoqatës nacionale

Më 21 maj u shënuar përvjetori i pavarësimit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Me këtë rast nga ana e OKKK-ve dhe KKQSH-së u organizuan sesione të diseminimit dhe u promovua roli dhe vendi i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Sesionet e diseminimit dhe punëtoritë me ARM-në

Gjatë vitit 2018 u realizuan tetë punëtori në kazermat e Republikës së Maqedonisë ku përfaqësuesit e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë mbajtën ligjëratat duke prezantuar diseminimin e Lëvizjes, të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare dhe duke prezantuar aktivitetet e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Grupi i synuar i dëgjuesve ishin personat në uniforma me grada dhe ushtarët, të cilët me interesim ndoqën ligjëratat dhe shprehën kënaqësinë për bashkëpunimin. Në pjesën e diseminimit pjesëmarrësit u njohën me rolin dhe mandatin e Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, KNKK-në, FNKKGJK-në dhe Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë, emblemën e Kryqit të kuq dhe Të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare me një vështrim në Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë.

U realizuan dy trajnime për diseminues të organizatave komunale të OKKK-ve

Në periudhën 20-22.04.2018 dhe në periudhën 01-03.06.2018 në Qendrën "Solferino" në Strugë u zbatua në seminar i trajnimit të diseminuesve të rinj – vullnetarë të organizatave komunale të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Trajnimet u zbatuan me mbështetjen e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq. Në këto trajnime morën pjesë 39 vullnetarë të 32 organizatave komunale të Kryqit të kuq. Në trajnimet u zhvilluan disa përmbajtje tematike: zanafilla dhe themelimi i Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe roli, struktura dhe parimet themelore të Lëvizjes, emblemat e Lëvizjes, bazat e së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe prezantimi individual i mandatit dhe rolit të komponentëve të Lëvizjes, respektivisht të Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq, shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, dhe Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Theks i veçantë u vu në programet e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe u theksuan aktivitetet kryesore që janë duke u realizuar në organizatat komunale të Kryqit të kuq. Për pjesëmarrësit u prezantua modeli I diseminimit me të rinjtë dhe koncepti i diseminimit i cili përdoret në kuadër të programit të KKA-PVH – modeli i diseminimit.

U zbatuan sesione diseminimi për diseminues të OKKK-ve

Gjatë vitit 2018 u realizuan 106 ligjëratat diseminimi në shkolla, fakultete, institucione dhe grupe qytetarësh. Sesionet e diseminimit u organizuan nga diseminues të aftësuar të cilët zhvilluan ligjëratat me ndihmën e veglave të unifikuara të diseminimit. Sesionet e diseminimit ishin me theks në historinë e Lëvizjes, parimet themelore, emblemat e Lëvizjes, Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë dhe fushat programore të veprimit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Sesionet e diseminimit për studentët

Në përputhje me memorandumit e nënshkruar të bashkëpunimit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë me Universitetin MIT, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë më 30 tetor të vitit 2018 zhvilloi një sesion diseminimi për studentët e Universitetit MIT për promovimin e punës së Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, Shoqatës nacionale, respektimin e së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe rolin dhe mundësitë e bashkëpunimit. Sesioni i diseminimit para studentëve përfshiu shumë kapituj të punës së Lëvizjes dhe DHN-së, si për shembull një vështrim të shkurtër në historinë e Lëvizjes, parimet themelore, emblemat e Lëvizjes dhe rolin e tyre tregues dhe mbrojtës, Konventat e Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokollet Shtesë të Konventave të Gjenevës së vitit 1977 dhe 2005, fushat programore të veprimit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, si dhe përvojat e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë të aktiviteteve gjatë kohës së katastrofave dhe situatave të jashtëzakonshme në Republikën e Maqedonisë dhe në vendet fqinje në dekadën e fundit.



Pjesëmarrja në seminarin me temën “Siguria ndërkombëtare dhe implementimi i Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare”

Në periudhën 19 – 20 shtator të vitit 2018, Ministria e Mbrojtjes organizoi një seminar me temën “Siguria ndërkombëtare dhe implementimi i Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare” në Qendrën e trajnimit “Dr. Xhozef Kruzel”, kazerma “Goce Dellçev” – Shkup. Në seminar morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, Armatës së Republikës së Maqedonisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Qendrës së Menaxhimit të Krizave, dhe Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Gjatë trajnimit, profesorë eminentë të Akademisë Ushtarake “Gjeneral Mihaillo Apostolloski” dhe të Universitetit MIT, zhvilluan sesione ndërvepruese përmes ligjëratave, rasteve studimore dhe zgjidhjes së problemeve në temat më aktuale të fushës së DHN-së, për të njohur pjesëmarrësit me aplikimin e Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare dhe për të pajisur ata me njohuri të reja për të.

Komiteti Nacional për Të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare (DHN)

Me seli në Kryqin e kuq të RM-së që u kryesua nga një përfaqësues i Ministrisë së Kulturës në periudhën e viteve 2016-2018, zhvilloi 5 takime të punës. Në trup u nominuan anëtarë të rinj nga ministrinë përkatëse dhe u iniciua një procedurë për miratimin e një programi të ri për punën e trupit për periudhën e viteve 2017-2018.

Qendra e diseminimit

Qendra e diseminimit e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë është një kënd i këndshëm i Organizatës që synon sigurimin e hapësirës dhe publikimeve për Lëvizjen Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare që mund të përdoren nga studentët, vullnetarët dhe punonjësit dhe qytetarët e interesuar të cilët duan të pasurojnë njohuritë e tyre për Kryqin e kuq. Qendra ndodhet në ambientet e Zyrës qendrore të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Gjatë vitit u evidentua literatura dhe materiali informativ i përgjithshëm në Qendrën e diseminimit. Një pjesë e madhe e materialeve gjithashtu janë në dispozicion në formën elektronike në ueb-faqen e KKRМ-së.



PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE

Gjatë vitit 2018 u zhvilluan 150 projekte të vogla për mirëqenien e komunitetit të cilët ndihmuan 3183 persona në gjithë vendin dhe 22 prej tyre u vlerësuan me diell, ose projekte që kanë efekte afatgjata për disa nga grupet e synuara. Gjithsej 1 036 të rinj, vullnetarë potencialë përfunduan trajnimin e diseminimit dhe trajnimin për përpunimin e projekteve të vogla, gjetjen e grupit të synuar, vlerësimin e nevojave, implementimin dhe dokumentimin e punës së bërë. Në periudhën e veprimit, nga shkurti deri në prill, janë investuar 26.199 orë vullnetare për komunitetin dhe janë mbledhur 31.028 euro të cilat janë investuar prapë në komunitet.

Pas trajnimeve që u organizuan në muajin janar dhe shkurt, në periudhë prej 2 muajsh, nën drejtimin e mentorimit të 34 diseminuesve të trajnuar mirë nga ana jonë u realizuan projektet. U krijua një grup mbështetës ku diseminuesit ndanë arritjet e tyre.

U zhvillua një punëtori finale, tradicionalisht në H. "Solferino" - Strugë, ku morën pjesë 80 të rinj, përfaqësues të projekteve më të mira, të projekteve që me të vërtetë kanë bërë ndryshime në komunitet dhe që kanë realizuar më së shumti orë vullnetarë gjatë kohës së implementimit të projekteve së bashku me diseminuesit. Gjatë punëtorisë finale dyditore, edhe sivjet të rinjtë morën njohuri të thella për kulturën si sistem i vlerave dhe udhëzime për vullnetarizmin në organizatat e tyre komunale lokale dhe gjithsesi udhëzime për shënimin e Javës së PVH-së.

Të inkurajuar nga përmbushja e përkushtuar e qëllimit strategjik të Strategjisë 2020 d.m.th. promovimi i kulturës së jo dhunës, paqes dhe tolerancës dhe nevoja për angazhimin plotësues të të rinjve pas punëtorive finale në Strugë, si dhe për të drejtuar ambiciet e këtyre të rinjve, shënohet java e PROMOVIMIT TË VLERAVE HUMANE, në kuadër të aktiviteteve tradicionale kalendarike të shoqatës nacionale në periudhën 21-27 shtator. Të rinjtë, secili në qytetin e tij, por nën të njëjtën temë "Promovimi i diversitetit" përgatitën një "Ngjarje PVH" përmes së cilës patën mundësinë për të bërë një përzgjedhje të mysafirëve që prezantuan historitë e tyre pozitive dhe gjërat që ata i bëjnë në komunitetin e tyre. U organizuan 28 ngjarje ku folën 80 folës në mbarë vendin. 391 të rinj morën pjesë aktive në përgatitjen e ngjarjeve dhe 2791 persona ishin mysafirë të ngjarjeve. Çdo i ri që kishte punuar një projekt mori një falënderim. U dhanë gjithsej 1 036 falënderime.

Manifestimi "Trofeu PVH" vazhdoi edhe sivjet me qëllim të promovimit të aktiviteteve, të rinjve dhe diseminuesin. Këtë vit Organizata komunale – Radovish fitoi trofeun meqë grupi i saj kishte punuar një numër më të madh projektesh të vogla që u vlerësuan me diell – projekte me efekte afatgjata në komunitet.

Programi vazhdon të inkurajojë të rinjtë të ndryshojnë rutinën e tyre të përditshme dhe të bëjnë ndryshime për veten dhe komunitetin e tyre, duke shfrytëzuar kapacitetet e tyre për t'u ndërtuar në liderë të ardhshëm dhe qytetarë të përgjegjshëm.





Përshkrimi i disa projekteve të vogla

OKKK PRILEP "Shndriti fuqishëm dita". Të rinjtë që realizuan këtë projekt synuan të sigurojnë përsëri instalimin e energjisë elektrike në shtëpinë familjare të një personi të papunë 46-vjeçar me probleme shëndetësore dhe të birit të tij 13-vjeçar, nxënës i Prilepit. Familja jeton pa energji elektrike për shkak të borxhit të papaguar dhe zjarrit që ndodhi në shtëpinë e familjes një vit më parë dhe dëmtoi instalimin elektrik.

Të rinjtë organizuan disa ngjarje dhe aktivitete përmes së cilave arritën të grumbullojnë fonde të mjaftueshme për të blerë materiale për instalimin e ri elektrik, për të paguar borxhin e papaguar dhe familja të marrë përsëri energji elektrike në shtëpinë e tyre.

OKKK GOSTIVAR "Uniteti". Ekipi i projektit me përbërje të ndryshme nacionale dhe gjuhësore, duke perceptuar problemin e komunikimit dhe mirëkuptimit të dobët ndërmjet nxënësve në shkollat e Gostivarit, pas konsultimeve me ekspertë, vendosi të realizojë mësimet për të mësuar gjuhën maqedonase dhe shqipe. Ky projekt ishte i dedikuar për të rinj – nxënës të klasave të nënta, nga 10 veta prej dy grupeve gjuhësore. U mbajtën 16 orë në gjuhën shqipe dhe 11 orë në gjuhën maqedonase. Për orët u angazhuan arsimtarë që mundësuan një qasje të plotë metodologjike, gramatikë dhe aktivitete ndërveprimi dhe argëtimi, me ç'rast u zhvillua vullneti, nevoja, mirëkuptimi dhe komunikimi, si dhe respektimi dhe miqësimi i ndërsjellë.

OKKK VINICË "Bëj një vepër të mirë dhe ndriçoje jetën e errët të dikujt". Qëllimi i të rinjve në këtë projekt ishte të ripërtërijnë tualetet në internatin në f. Bllatec ku qëndrojnë fëmijë me zhvillim të ngadalësuar.

Për të realizuar një gjë të tillë, vullnetarët organizuan dy ngjarje: një pazar humanitar për punime të 8 Marsit dhe një argëtim humanitar bardhë e zi. Për këtë qëllim ata kërkuan donacione nga kompanitë, të cilat siguruan materialet e nevojshme dhe njëra nga kompanitë u siguroi atyre një mjeshtër për rindërtimin e tualeteve.

MENAXHMENTI VULLNETAR

Vullnetarizmi në Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë

Në vitin 2018 janë bërë përpjekje të konsiderueshme në përparimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, dhe para së gjithash të vullnetarëve dhe anëtarëve të Organizatës së Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Në periudhën 23-25 shkurt të vitit 2018 u mbajt një takim me sekretarët e të gjitha OKKK-ve dhe KKQSH-së ku u identifikuan sfidat e punës dhe u përcaktuan prioritetet për përmirësimin e situatës me anëtarët dhe vullnetarët. U miratua Plani i Veprimit për aktivitetet i cili u zbatua deri më 31.12.2018.

Promovimi i akteve për organizimin e anëtarësimit dhe vullnetarizmit në Kryqin e kuq të RM-së

U promovua "Rregullorja për metodologjinë e përcaktimit të numrit minimal të anëtarëve në organizatat komunale të Kryqit të kuq" dhe "Rregullorja për pranimin dhe përfundimin e anëtarësimit në Kryqin e kuq të RM-së" dhe vendimet për shumën e anëtarësisë për personat deri në 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç të miratuara më 25.12.2018.

Themelimi i një sistemi elektronik për evidentimin dhe monitorimin e vullnetarëve dhe anëtarëve

Në kuadër të zgjidhjeve softuerike të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë u fut një sistem i evidentimit elektronik i të dhënave të vullnetarëve dhe anëtarëve dhe i aktiviteteve të tyre në Kryqin e kuq. Me këtë sistem mundësohet një pasqyrë më e mirë e situatës me burimet njerëzore, pasqyrën e kompetencave, anëtarësimin e paguar, numrin e orëve vullnetare, interesimet për përfshirjen në fusha të caktuara programore etj.

Zbatimi i një sistemi për orientimin e personave të interesuar për t'u përfshirë në Kryqin e kuq

Orientuesit janë persona që do të jenë të obliguar për të organizuar sesione orientuese për të gjithë personat e interesuar për të qenë pjesë e Organizatës si vullnetarë, anëtarë ose mbështetës. Në periudhën 11-13 qershor të vitit 2018 në Strugë u organizua një trajnim i veçantë për 35 përfaqësues të përzgjedhur të OKKK dhe KKQSH, ku u përpunua një program i unifikuar i sesioneve orientuese dhe u dha një komplet i veçantë për orientuesit që përmban një doracak të përgatitur në mënyrë të veçantë, një çantë shpine, kanotiere, distinktiv, kartelë identifikimi, format për vizit-karta dhe formate pyetësorësh dhe raportesh. Deri në fund të vitit janë organizuar gjithsej XXX sesione orientuese nga të cilat interesim për vullnetarizëm kanë treguar XXX persona, dhe janë anëtarësuar gjithsej XXX persona.

Konferenca e vullnetarizmit

Më 4 dhjetor në ambientet e Muzeut të Qytetit të Shkupit u organizua Konferenca e vullnetarizmit me sloganin "Vullnetarët ndërtojnë komunitete të qëndrueshme". Në këtë ngjarje fjalim hyrës pati Kryetari i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, Prof. Dr. Romel Velev, ndërsa pjesëmarrës së konferencës ishin Dr. Sait Saiti – Sekretar i përgjithshëm i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, Milla Carovska – Ministre e Punës dhe Politikës Sociale, Irena Ivanova – përfaqësuese e delegacionit të Evropës në Shkup, Lidija Dimova – Drejtore e Agjencisë Nacionale për programe arsimore evropiane dhe mobilitet, Aleksandar Ristovski i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, Blazhen Malevski – Kryetar i Këshillit nacional rinor në Forumin arsimor rinor, Prof. Marija Topuzovska Latković – Instituti i Hulumtimeve Sociologjike dhe Politike Juridike, Ivana Marinček – Oda e Psikologëve të Republikës së Maqedonisë, Prof. Rade Rajkovčevski – Fakulteti i Sigurisë – Shkup i Universitetit "Shën Klimenti i Ohrit" – Manastir, Zhivko Mukaetov – SHA Alkaloid Shkup. Qëllimi i Konferencës ishte aktualizimi i çështjeve të lidhura me vullnetarizmin dhe organizimin e punës vullnetare. Përmes paneleve u përpunua korniza normative e vullnetarizmit në RM, rëndësia e vullnetarizmit për ndërtimin e një shoqërie të sigurt dhe të shëndetshme, dhe përfaqësuesit e shoqatave civile prezantuan praktikat më të mira në organizimin e aksioneve vullnetare. Në këtë ngjarje me rastin e "5 Dhjetorit – Ditës Botërore të Vullnetarizmit", u nda mirënjohja Anri Dynan për Jane Nedellkovskin, Marija Stojkovën, Stojçe dhe Emi Tocinovskin, Aleksandar Ristovskin, për realizimin dhe promovimin e ideve të Kryqit të kuq, dhe falënderime për Kolegjiun KKA-PVH dhe SHA Alkaloid Shkup për pjesëmarrjen shumëvjeçare dhe kontributin në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.



Projekti: Ndhimja e parë psikologjike dhe mbështetja psikosociale në situata emergjente (PFA-CE)

Projekti për forcimin e kapaciteteve të Shoqatës nacionale për Ndhimën e parë psikologjike dhe mbështetjen psikosociale në situata emergjente zbatohet në SHN-të e Kryqit të kuq të Austrisë, Serbisë, Kroacisë, Maqedonisë dhe Italisë, si dhe Universiteti i Innsbruket (Austri), në periudhën prill i vitit 2017- prill i vitit 2019. Gjatë vitit 2018 theksi është vënë në hulumtimin e veglave ekzistuese dhe rekomandimet për (1) Ndhimën e parë psikologjike, (2) aktivizimin dhe pjesëmarrjen e komuniteteve dhe (3) mbështetjen e vullnetarëve dhe punonjësve duke përfshirë udhëzimet për koordinimin dhe mbështetjen e vullnetarëve konvergjentë dhe spontanë. Pas zbatimit të një hulumtimi nga ana e Universitetit është krijuar një paket për trajnimin e trajnuesve përmes një shkëmbimi të strukturuar të përvojave dhe mbledhjes së praktikave më të mira në zonat e prekura nga përmbytjet, tërmetet ose nga kriza e migruesve. Për nevojat e projektit u mbajt një punëtori në Kranj, Slloveni (18/19.06.2018). Ekipi i projektit u takua dhe në Lozen – Bullgari gjatë kohës së takimit të Rrjetit Evropian për mbështetjen psikosociale të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Në periudhën 07-09 dhjetor të vitit 2018 në Beograd u mbajt një trajnim i trajnerëve për të shumëfishuar veglat në shoqatat e tyre nacionale. Në periudhën e ardhshme deri në fund të projektit do të vijojnë aktivitetet për integrimin e veglave në sistemin e shoqatës nacionale për gatishmëri dhe veprim në katastrofa dhe shkëmbimin e tyre me institucionet dhe organizatat tjera në vend që janë aktive gjatë kohës së situatave të jashtëzakonshme.

AKTIVITETET RINORE

Në vitin 2018 vullnetarët e rinj të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë u përfshinë aktivisht në përgjigjen ndaj sfidave humanitare me të cilat u përball popullsia në Republikën e Maqedonisë. Si përgjigje ndaj lëvizjes migruese dhe katastrofave natyre që prekën vendin tonë (përmbytjet, valët e të ftohtit, valët e të nxehtit) në kuadër të klubeve të të rinjve në organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit u organizua një numër i madh edukatash, aksionesh mbështetëse të grumbullimit, vizitash në terren për të vlerësuar dëmet, distribucionesh të ndihmës, këshillimesh etj, në drejtim të zbutjes së pasojave dhe parandalimit të përkeqësimit të situatës.

Me kreativitetin dhe inventivitetin e tyre, të rinjtë dhanë një kontribut të madh në aktivitetet e përgjithshme të Shoqatës nacionale në drejtim të mbështetjes së popullsisë së prekur dhe në mënyrë masive u përfshinë në implementimin e aktiviteteve gjatë kohës së situatave emergjente. Deri më 31.12.2018 në 33 klube të të rinjve pranë OKKK dhe KKQSH aktivë ishin 2618 vullnetarë të rinj që është një rritje prej 581 vullnetarësh për këto klube të të rinjve në krahasim me vitin e kaluar.

Kampi veror për trajnimin e vullnetarëve të rinj "100% Kryq i kuq"

Të rinjtë e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në periudhën 01-07 korrik të vitit 2018 në Velestovë Ohër organizuan një trajnim për marrjen e njohurive dhe shkathtësive për organizimin e të rinjve në klubet e tyre, zhvillimin e mbledhjeve, krijimin e aktiviteteve, transmetimin efektiv të informacionit, njohjen më të mirë me strukturën dhe aktivitetet e Shoqatës nacionale, ngritjen e iniciativave në nivelin lokal dhe nacional, organizimin e të rinjve në klubet shkollore dhe gjëra të tjera që janë të rëndësishme për punën e klubeve të të rinjve. 64 vullnetarë të rinj të 27 Klubesh të rinjsh patën mundësinë për të forcuar kapacitetet e tyre për një kontribut më efikas dhe më efektiv në punën e Shoqatës nacionale. Gjatë trajnimit përmes një kompleti punëtorish u përpunuan modelet e veprimit përmes shkollave fillore dhe në mënyrë të përditshme u zhvilluan prezantime për shkëmbimin e përvojave të punës së secilit klub. Pas përfundimit të kampit pjesëmarrësit morën udhëzime dhe detyra të punës për periudhën shtator-dhjetor të vitit 2018.



“Të rinjtë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore”

Duke pasur parasysh numrin e rritur të lëvizshmërisë së popullsisë së re në vendin tonë si rezultat i situatës politike dhe socio-ekonomike, gjatë vitit 2018 një theks i madh u vu në aktivitetet për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore tek popullsia e re. Në bashkëpunim me Federatën ndërkombëtare u siguroa mbështetja për projektin “Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore, në kontekst të migrimëve” ku morën pjesë 11 OKKK dhe KKQSH, dhe u realizuan punëtori me 210 përfaqësues të vetëqeverisjes lokale si dhe 844 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme.

“Devijimi pozitiv” – projekt për mbështetjen e romëve të rinj në Shuto Orizari

Membështetjen e FNKKGJK në kuadër të programit për ngritjen e kapaciteteve dhe me mbështetjen e Fondit Shoken për mbështetjen e projekteve, në periudhën tetor i vitit 2017 – maj i vitit 2019, u realizua implementimi i projektit “Devijimi pozitiv” dedikuar për popullsinë romë në Komunën Shuto Orizari. Projekti synon zhvillimin e një mënyre të re dhe inovative për t’u qasur problemit shumëvjeçar të shumë nxënësve romë të cilët shënojnë rezultate shumë më të ulëta në shkollë në krahasim me të tjerët. Projekti përdor metodën “Devijimi pozitiv” me qëllim të identifikimit të sjelljeve pozitive, duke u mundësuar disa nxënësve romë për të pasur rezultate shumë më të mira se nxënësit tjerë, edhe krahas faktit se ata përballen me të njëjtat sfida shoqërore si dhe bashkëmoshatarët e tyre. Gjithsej 220 nxënës të Shkollës së Mesme “Shaip Jusuf” në Shuto Orizari ishin pjesëmarrës aktivë në punëtoritë deri në maj të vitit 2018, ndërsa nga shtatori i vitit 2018 aktivitetet janë duke u implementuar në Shkollën Fillore “Vëllezërit Ramiz dhe Hamid”. Punëtoritë përfshijnë një bisedë ndërvepruese me prindërit, nxënësit dhe arsimtarët, ku përmes një grupi të caktuar temash dhe veglash identifikohen devijimet pozitive dhe faktorët e mundshëm që ndikojnë në suksesin më të mirë të individëve të caktuar.

“Parandalimi i sëmundjeve të varësisë tek popullsia e të rinjve”

Me mbështetjen e Agjencisë së Rinisë dhe Sportit në komunat Negotinë, Shtip, Gostivar dhe Manastir, organizuar nga vetëqeverisjet lokale dhe shkollat fillore në territorin e tyre, vullnetarët e Kryqit të kuq zbatuan edukime të bashkëmoshatarëve për parandalimin e nikotinizmit, alkoolizmit dhe keqpërdorimit të drogave. Në kuadër të projektit u përfshinë 3345 nxënës të gjithsej 17 shkollave fillore.

“Shëndet në komunitetet – Edukimi i bashkëmoshatarëve për parandalimin e infeksioneve të transmetueshme seksualisht”

Në periudhën 15-17.12.2018 dhe 22-24.12.2018 në Qendrën e trajnimit të kuadrove “Solferino” në Strugë u mbajtën punëtori për trajnimin e edukatorëve të bashkëmoshatarëve për parandalimin e infeksioneve të transmetueshme seksualisht për gjithsej 50 përfaqësues të 18 OKKK-ve dhe KKQSH-së, të cilët patën mundësinë për të marrë njohuri dhe shkathtësi për rritjen e ndërgjegjes tek të rinjtë për infeksionet e transmetueshme seksualisht që janë më të përhapura në vendin tonë. Gjatë punëtorive theksi u vu në rëndësinë e zbatimit të metodologjisë së edukimit të bashkëmoshatarëve në programet që direkt kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë e të rinjve. Sesionet u zbatuan në përputhje me një doracak të përgatitur në mënyrë të veçantë për edukatorët e bashkëmoshatarëve i cili është në përputhje me “Standardet e edukimit të bashkëmoshatarëve” të Organizatës Shëndetësore Botërore.

Klubet shkollore të Kryqit të kuq në shkollat fillore

Në vitin 2018 u zbatua moduli pilot për punën e të rinjve i cili është në kuadër të klubeve shkollore në institucionet arsimore. Bëhet fjalë për një formë organizimi të vullnetarëve që fizikisht ndodhet më afër popullsisë, respektivisht u mundëson të rinjve për t’u organizuar më afër shtëpive të tyre duke pasur parasysh se klubet e të rinjve në OKKK organizojnë punën e tyre në zyrat e OKKK-ve. Klubet shkol-



lore kanë një program të unifikuar në përputhje me programin e mësimdhënies së shkollës për gjithë vitin shkollor. Ata janë të koordinuar nga ana e një vullnetari përgjegjës i Kryqit të kuq dhe një arsimtari përgjegjës të shkollës. Në vitin 2018 janë formuar 67 klube shkollore në gjithsej 27 OKKK. Pas përfundimit të vitit shkollor moduli do të vlerësohet dhe do të jepen udhëzime për zgjerimin e qasjes në një numër më të madh shkollash fillore.

Edukatat e bashkëmoshatarëve për parandalimin dhe rritjen e ndërgjegjes

Vullnetarët e rinj janë pjesë integrale e punës së gjithmbarshme të Shoqatës nacionale. Në mënyrë plotësuese me aktivitetet e tyre në kuadër të klubeve të të rinjve janë organizuar edhe punëtoritë edukative në vijim në vitin 2018:



Tema	Numri gjithsej i punëtorive të zhvilluara	Numri gjithsej i pjesëmarrësve
Parandalimi i HIV/SIDA dhe i ITS	101	2311
Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore	105	2720
Parandalimi i sëmundjeve të varësisë	206	5332
Ndihma e parë	75	990
Diseminimi	78	1705
Mbrojtja e shëndetit të dhëmbëve	12	272
Promovimi i higjienës	13	468
Shprehitë e shëndetshme jetësore	29	910
Punëtori të tjera të parandalimit	28	707

Në gjithsej 647 punëtori edukative janë përfshirë 16.122 pjesëmarrës.

Në gjithsej 28 Organizata komunale të Kryqit të kuq janë organizuar gara komunale të ndihmës së parë ku në mënyrë aktive kanë marrë pjesë 1410 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme.

GATISHMËRIA DHE VEPRIMI NË KATASTROFA DHE SITUATA TË KRIZËS

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në vitin 2018 në planin e gatishmërisë dhe veprimit në katastrofa, përparësi u dha aktiviteteve për uljen e rreziqeve të katastrofave, sigurimin e shërbimeve për popullsinë e prekur, ndërtimin e efektivitetit institucional, promovimin e bashkëpunimit të partneritetit për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, përmirësimin e avokimit nëpërmjet aktiviteteve ku jemi parë, dëgjuar dhe kemi qenë të pranishëm për t'u ndihmuar njerëzve që kanë nevojë. Një numër i madh aktiviteteve u zbatuan në nivel lokal, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe në përmirësimin e bashkëpunimit me vetëqeverisjen lokale dhe subjektet që janë pjesë e sistemit të menaxhimit të krizave në nivel lokal.

Projekti “Ulja e rreziqeve të katastrofave në shkollat fillore dhe çerdhet e fëmijëve në Gjevgjeli, Kumanovë dhe Shkup” mbështetur nga UNICEF-i

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në kuadër të Programit për gatishmëri dhe veprim në rast katastrofash, me mbështetjen e UNICEF-it realizoi projektin “Ulja e rreziqeve të katastrofave në shkollat fillore dhe çerdhet e fëmijëve në Gjevgjeli, Kumanovë dhe Shkup”. Aktivitetet e projektit u realizuan në 4 faza (vlerësimi, aktivitetet e infrastrukturës dhe përgatitja e materialeve, ndërtimi i kapaciteteve dhe kontrollimi i njohurive të marra). Në kuadër të fazës së parë të projektit në bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara dhe sipas metodologjisë së Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe u zbatua vlerësimi bazik dhe i detajuar i institucioneve arsimore në 9 komuna (Kumanovë, Gjevgjeli, Qendër, Çair, Butel, Gazi Babë, Kisella Vodë, Karposh dhe Gjorçe Petrov) dhe u përfshinë 71 çerdhe fëmijësh dhe 10 shkolla fillore. Pas kryerjes së vlerësimit dhe bërjes së analizës u përzgjedhën 11 institucione arsimore. Në fazën e dytë sipas aktiviteteve të projektit pas identifikimit të preksshmërisë së çdo objekti, u përpunuan plane konkrete (elaborate) të mbrojtjes dhe shpëtimit në rast katastrofash me 11 institucionet e përzgjedhura. Elaborati për mbrojtje dhe shpëtim është kusht i parashikuar me Ligjin e Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Dokumenti përmban të dhëna të përgjithshme të institucionit, vlerësimin e preksshmërisë dhe përshkruan rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve para, gjatë dhe pas katastrofës. Pas përgatitjes së planeve të evakuimit u zbatua instalimi i pajisjes përkatëse të evakuimit si shenja, komplete të ndihmës së parë etj. Për secilin institucion në mënyrë grafike u përgatitën, u shtypën dhe u futën në kornizë gjithsej 42 plane të evakuimit. Në fazën e tretë të projektit u realizuan gjithsej 25 trajnime në 11 institucione arsimore me temën “Mbrojtja dhe vetëmbrojtja në rast katastrofash” dedikuar për punonjësit, fëmijët dhe prindërit.

Në këto trajnime morën pjesë gjithsej 640 persona. Gjatë trajnimeve u përpunuan karakteristi-

kat kryesore të katastrofave (natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu), si dhe cilat aktivitete duhet të ndërmerren para, gjatë dhe pas katastrofave. Gjithashtu, në kuadër të sesioneve, pjesëmarrësit patën mundësinë për të demonstruar njohuritë e marra përmes ushtrimeve interaktive. Në fazën përfundimtare të projektit u përgatitën dhe u zbatuan 14 ushtrime simulimi për evakuimin e personelit dhe fëmijëve në çerdhet dhe shkollat fillore. Gjatë ushtrimeve të simulimit, personeli i çerdheve dhe shkollave fillore në koordinim me ekipet e Kryqit të kuq të RM-së dhe ekipet e ndihmës së parë të OKKK (Qendër, Karposh, Gazi Babë, Kisella Vodë, Kumanovë dhe Gjevgjeli) zbatuan procedurat e mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes në rast të katastrofave, evakuimit dhe ndihmës së parë. Në këto ushtrime u përfshinë më shumë se 7000 nxënës, fëmijë dhe personel (direkt dhe indirekt).



Projekti për uljen e rreziqeve të katastrofave në Manastir dhe Gostivar mbështetur nga FNKK/GJK

Projekti për uljen e rreziqeve të katastrofave që u realizua në periudhën e viteve 2017–2018 përfshin një grup aktivitete për përmirësimin e menaxhimit të rreziqeve në fatkeqësitë elementare në nivel lokal, në përputhje me nevojat e grupeve të synuara më të prekshme: fëmijët, nxënësit dhe të moshuarit, si dhe forcimin e kapaciteteve të organizatave lokale. Aktivitetet bazohen në një qasje inovative për rritjen e ndërgjegjes së popullsisë së përgjithshme, veçanërisht të popullsisë në mjediset rurale. Në të njëjtën kohë projekti përfshin aktivitetet e analizës së rreziqeve parësore dhe rreziqet e pranishme në të dyja komunat. Qëllimi kryesor është forcimi i kapaciteteve të institucioneve lokale, të vullnetarëve të Kryqit të kuq dhe popullsisë së përgjithshme dhe rritja e rezistencës së komunitetit nga fatkeqësitë natyrore dhe aksidentet në komunat Gostivar dhe Manastir.

Numri i të rinjve të targetuar direkt në të dy komunitetet (Manastir dhe Gostivar) përmes edukimit dhe dy ushtrimeve simuluese është 900 persona, ndërkaq përdorues indirekt të projektit janë familjet dhe miqtë e tyre (rreth 4000-5000). Për ngritjen e kapaciteteve dhe bashkëpunimin rajonal u zhvillua një trajnim për metodologjinë e vlerësimit të kapaciteteve - 30 vullnetarë të trajnuar për VCA dhe një punëtori për leksionet e mësuara - 20 përfaqësues të shoqatave të tjera nacionale – për shkëmbimin e përvojave. Gjithashtu në kuadër të projektit përfundoi përgatitja e Procedurave Standarde Operative të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë për gatishmëri dhe veprim në rast të katastrofave.

Trajnimi për gatishmëri dhe veprim në rast katastrofash dedikuar për OKKK-të

Në periudhën 22–24.03.2018 në Qendrën e trajnimit "Solferino" në Strugë, organizuar nga Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë u zhvillua një trajnim i aftësisimit bazik për gatishmëri dhe veprim në katastrofa dhe uljen e rreziqeve të katastrofave, ku morën pjesë 27 pjesëmarrës të 11 organizatave komunale të Kryqit të kuq (Vallandovë, Negotinë, Radovish, Kavadar, Strugë, Koçanë, Vinicë, Prilep, Ohër, Strumicë, Shtip) dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Qëllimi kryesor i trajnimit ishte ngritja e kapaciteteve të vullnetarëve të Kryqit të kuq dhe forcimi i rezistencës, rritja e efikasitetit në reagimin në rast të katastrofave dhe shkëmbimi i përvojave në fushën e reagimit në katastrofa.



Trajnimi dhe ushtrimi simulues për nevojat e vetëqeverisjes lokale Karposh

Më datë 01.10.2018 në ambientet e Njesisë së Vetëqeverisjes Lokale Karposh, për nevojat e njesisë së tyre për gatishmëri dhe reagim në rast katastrofash u zhvillua një ligjëratë për vendin dhe rolin e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në menaxhimin e situatave të krizës me theks në përmbytjet. Në këtë trajnim morën pjesë 10 pjesëmarrës, persona të angazhuar profesionalisht në NjVL Karposh. Pjesëmarrësit në këtë ligjëratë patën mundësinë për t'u njohur me aktivitetet e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, të cilat realizohen në kushte të katastrofave dhe në situata të krizës, me drejtimet/rregullat themelore të komunikimit koordinimit me institucionet shtetërore që janë pjesë e sistemit të menaxhimit të krizave dhe mbrojtjes dhe shpëtimit, shpërndarjen e ndihmës humanitare (distribucionin), strehimin e popullsisë në rast të katastrofave, sigurimin e ndihmës humanitare dhe të sigurisë personale në rast të katastrofave.

Më 04 tetor u zhvillua një ushtrim i përbashkët simulimi për shpëtimin e personave nga një anije e përmbytur në liqenin Matka ku morën pjesë shpëtimtarë të ujit nga të dy institucionet.

Pjesëmarrja në ushtrimin e shpëtimit në mal organizuar nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Në periudhën 02–04 mars të vitit 2018 në Kodrën e Diellit u zhvillua ushtrimi për shpëtimin në mal, njohja me bazat e teknikës së lëvizjes në kushte dimërore, taktika për kërkimin dhe shpëtimin e personave nga ortekët, procedurat e përdorimit të ekipeve për reagim të shpejtë, ofrimi i ndihmës së parë mjekësore, kujdesi për të lënduarit dhe riparimi i pasojave. Pjesëmarrës të ushtrimit ishin ekipet e shpëtimit të Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Federata e Sporteve Malore e RM-së dhe Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë.

Punëtorja për “Përgatitjen gjeohapësinore për reagim në katastrofa” organizuar nga Ministria e Mbrojtjes

Në periudhën 26–29 mars të vitit 2018 organizuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Korpusi i Inxhinierisë së Armatës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës u zhvillua një punëtori me temën “Përgatitja gjeohapësinore për reagim në katastrofa”. Në këtë punëtori me përfaqësues të tij mori pjesë edhe Kryqi i kuq i R. së Maqedonisë. Qëllimi i punëtorisë ishte të pajisurit e pjesëmarrësve me njohuri për përdorimin e softuerit të platformës së komunikimit të bazuar në ueb. “Gjenerata e ardhshme e sistemit të menaxhimit/komandimit në incidente” (Next-Generation Incident Command System – NICS), duke zbatuar në mënyrë praktike njohuritë dhe përvojat e dala dhe të marra nga Sistemi i menaxhimit/komandimit në incidente (Incident Command System), i cili është i zhvilluar dhe tanimë një kohë të gjatë përdoret në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. “NICS” është një vegël e bazuar në ueb dedikuar kryesisht për rritjen e ndërgjegjësimit në situatë të ekipeve të reagimit në situata emergjente dhe katastrofa, si dhe për bashkëpunim më efikas dhe më efektiv dhe interoperabilitet ndërmjet agjencive në raste situatash emergjente dhe katastrofash. Vegla ueb ka mundësinë e përmirësimit të vazhdueshëm dhe integritimit në sistemet ekzistuese në Republikën e Maqedonisë dhe në rajon, është i besueshëm dhe në të njëjtën kohë posedon arkitekturë që lejon një distribucion të lehtë dhe qasje të lehtë për të gjithë subjektet e përfshira, si dhe për subjektet që në mënyrë plotësuese do të tregojnë interesim për t’u përfshirë në këtë projekt.



Ligjërata mbi “Rolin e Kryqit të kuq në ballafaqimin me fatkeqësitë natyrore dhe elementare dhe aksidentet” për studentët e Fakultetit të Sigurisë – Shkup

Në bazë të memorandumit të bashkëpunimit me Fakultetin e Sigurisë – Shkup, në ambientet e Kryqit të kuq të R. së Maqedonisë më datë 21.03.2018 u mbajt një ligjëratë për studentë në temën “Roli i Kryqit të kuq në ballafaqimin me fatkeqësitë natyrore dhe elementare dhe aksidentet”.



Punëtorja dhe ushtrimi i evakuimit në bashkëpunim me Axhibadem Sistina dhe Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Shpëtimit

Organizuar nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit, më 22-23 qershor të vitit 2018 u zhvillua një punëtori në temën “Evakuimi i pacientëve, të lënduarve, personelit dhe vizitorëve të spitaleve, me skenarin e një tërmeti”. Në këtë punëtori morën pjesë përfaqësues të mbrojtjeve civile të Sllovenisë, Kroacisë, B e H-së, Malit të Zi, Rumanisë, Bullgarisë dhe Turqisë, si dhe përfaqësues të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Brigadës Territoriale të Zjarrfikësve të qytetit të Shkupit. Qëllimi i punëtorisë ishte kontrollimi i procedurave të evakuimit në spitalin “Axhibadem Sistina”, si dhe stërvitja e ekipeve të reagimit në rast katastrofash për evakuimin e personave, transportimin e personave matanë lumit, ndihma e parë, akomodimi i pacientëve/të lënduarve në një qendër triazhi. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në këtë ushtrim mori pjesë me një ekip prej gjashtë vetash. Pas përfundimit të ushtrimit u mbajt një briefing/takim, ku pjesëmarrësit dhe mysafirët patën rastin të shkëmbejnë përvojat dhe ekspertizën për ushtrimin e mbajtur të simulimit.

Trajnimi ndërkombëtar për reagim në rast përmbytjesh

Në periudhën 14–18.05.2018 në rrethinën e Kresnës – Republika e Bullgarisë, organizuar nga Kryqi i kuq i Bullgarisë u mbajt një stërvitje ndërkombëtare trajnimi për reagim në rast përmbytjesh ku morën pjesë përfaqësues të Kryqit të kuq të Bullgarisë, Kryqit të kuq të Rumanisë, Kryqit të kuq të Hungarisë dhe Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Qëllimi kryesor i trajnimit ishte ngritja e kapaciteteve të vullnetarëve/përfaqësuesve të shoqatave nacionale dhe forcimi i rezistencës, rritja e efikasitetit në reagimin në rast katastrofash në nivel rajonal dhe shkëmbimi i përvojave në fushën e reagimit në katastrofa. Gjatë trajnimit u përpunuan temat e shpëtimit në ujë, ushtrime praktike për lëvizjen në lumë, ndihma e parë, puna me litarët e shpëtimit, teknikat dhe navigacioni me një barkë, grimi/shfaqja realiste e lëndimeve, uji, saniteti dhe promovimi i higjienës, radio-komunikimi dhe ushtrimet e simulimit. U ndanë përvojat praktike nga terreni për përmbytjet dhe u prezantua puna e stacionit të pastrimit të ujit të Kryqit të kuq të R. së Maqedonisë.

Takimi rajonal i koordinatorëve për gatishmëri dhe veprim në katastrofa në Bullgari

Organizuar nga Kryqi i kuq i Bullgarisë dhe Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, në periudhën nga 31.10. deri më 3.11. të vitit 2018 në Sofje u mbajt takim pune i koordinatorëve për gatishmëri dhe veprim në rast katastrofash të shoqatave nacionale të Kryqit të kuq dhe

Gjysmëhënës së kuqe. Në këtë takim pune morën pjesë përfaqësues të SHN të Kryqit të kuq të Austrisë, Maqedonisë, Bullgarisë, Serbisë, Hungarisë, Rumanisë, B e H-së, Gjermanisë, Gjeorgjisë, Gjysmëhëna e kuqe e Turqisë dhe Azerbajxhanit, si dhe përfaqësues të FNKK/GJK. Qëllimi i takimit të punës ishte shkëmbimi i praktikave dhe përvojave të SHN-ve të rajonit me theks në përmbytjet, përgatitjen e procedurave standarde operative për Ekipeve nacionale të reagimit në rast katastrofash, SOP për anëtarët e ekipeve rajonale të reagimit në rast katastrofash si dhe përgatitja e planeve të ardhshme në fushën e gatishmërisë dhe veprimit në rast të katastrofave. Në takimin e punës, pjesëmarrësit patën mundësinë për të parë propozim bashkëpunimin me EFAS (sistemi i parë evropian i monitorimit dhe parashikimit të përmbytjeve në të gjithë Evropën). Përfaqësuesi i FNKK/GJK prezantoi planet dhe idetë për vitin e ardhshëm në fushën e gatishmërisë dhe veprimit në rast të katastrofave, si dhe detyrat dhe rolet e menaxherit të informimit.

Punëtorja rajonale për menaxhimin e katastrofave në Qendrën e trajnimit "Solferino"

Në periudhën 21 – 23.11.2018 në Qendrën e trajnimit "Solferino" në Strugë u zhvillua Punëtorja rajonale për menaxhimin e katastrofave me pjesëmarrjen e 22 përfaqësuesve të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq, Kryqit të kuq të Bullgarisë, Kryqit të kuq të Shqipërisë, Kryqit të kuq të Serbisë, Kryqit të kuq të Malit të Zi, Yllit të kuq të Davidit të Izraelit dhe Qendrës së Menaxhimit të Krizave të Republikës së Maqedonisë. Qëllimi kryesor i punëtorisë ishte shkëmbimi i përvojave dhe thellimi i bashkëpunimit midis përfaqësuesve të Shoqatave nacionale në fushën e reagimit në rast të përmbytjeve dhe përmirësimi i njohurive përmes trajnimit për përdorimin e NICS (Next-Generation Incident Command System).



Takimi në kuadër të projektit "Shkolla dhe çerdhe të sigurt" i mbështetur financiarisht nga ERASMUS+

Organizuar nga Kryqi i kuq i Austrisë në periudhën nga 28.11. deri më 01.12.2018 në Austri – Vjenë u mbajt një takim pune fillestar në kuadër të projektit "Shkolla dhe çerdhe të sigurt" i mbështetur financiarisht nga Programi ERASMUS+. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të vendeve që janë bartëse të projektit: Kryqi i kuq i Austrisë, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, Kryqi i kuq i Bullgarisë dhe Kryqi i kuq i Serbisë. Aktivitetet e SHN-ve që morën pjesë në këtë projekt janë:

1. Kryqi i kuq i Kroacisë: Zhvillimi i katalogut të resurseve (materiale, vegla etj.) për uljen e rreziqeve të katastrofave dhe ndihma e parë dhe krijimi i moduleve të reja të edukimit për platformën e planifikuar.
2. Kryqi i kuq i Austrisë: Përgatitja e platformës onlajn për uljen e rreziqeve të katastrofave me një proces të certifikimit të shkollave fillore dhe çerdheve
3. Kryqi i kuq i Serbisë: Përgatitja dhe zbatimi i trajnimit onlajn dhe sy më sy për personelin mësimdhënës dhe promotorët e uljes së rreziqeve të katastrofave dedikuar për çerdhet dhe shkollat fillore
4. Kryqi i kuq i Bullgarisë: Përgatitja dhe zba-



5. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë: Avokimi i qasjes institucionale në implementimin e aktiviteteve për uljen e rreziqeve të katastrofave dhe ndihma e parë në programin e mësimdhënies në shkollat fillore dhe çerdhet

Punëtorja rajonale për leksionet e mësuara për uljen e rreziqeve të katastrofave në institucionet arsimore

Në periudhën 14 – 16.08.2018 në Qendrën e trajnimit “Solferino” në Strugë u zhvillua punëtorja rajonale për leksionet e mësuara për uljen e rreziqeve të katastrofave në institucionet arsimore. Në këtë punëtori morën pjesë 11 përfaqësues të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, Kryqit të kuq të Bullgarisë, Kryqit të kuq të Shqipërisë, Kryqit të kuq të Austrisë dhe Kryqit të kuq të Kroacisë. Qëllimi kryesor i punëtorisë ishte shkëmbimi i përvojave dhe thellimi i bashkëpunimit midis përfaqësuesve të Shoqatave nacionale të Bullgarisë, Shqipërisë, Kroacisë, Austrisë, Maqedonisë dhe FNKK/GJK në fushën e uljes së rreziqeve të katastrofave në institucionet arsimore si dhe qasja rajonale në realizimin e mëtejshëm të projekteve për uljen e rreziqeve dhe mbrojtja dhe vetëmbrojtja në rast të katastrofave.

Ushtrim simulimi – “Përgjigjja gjithëpërfshirëse Vodno 2018”

Në periudhën 17-21 shtator të vitit 2018 në Shtëpinë e ARM-së në Shkup, në përputhje me programin e bashkëpunimit civil ushtarak midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe Korpusit të Inxhinierisë së Armatës së SHBA-së u zhvillua një ushtrim simulimi – “Përgjigjja gjithëpërfshirëse Vodno 2018”, ku morën pjesë institucionet që janë pjesë e sistemit të menaxhimit të krizave dhe mbrojtjes dhe shpëtimit.

Bashkëpunimi me Gjysmëhënën e kuqe të Turqisë

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë me ndihmën financiare të Gjysmëhënës së kuqe të Turqisë, me rastin e festës së Ramazan Bajramit në muajin qershor të vitit 2018 në Shkup/Çair, Kumanovë dhe Radovish, me ndihmën e OKKK-ve dhe Shoqatën “Merhamet”, ndanë 850 pako me produkte ushqimore për familjet e prekshme në aspektin social të besimit islam.

Mbështetja dhe ndihma për migruesit dhe refugjatët në R.M.

Në vitin 2018 për nevojat e migruesve dhe refugjatëve në Republikën e Maqedonisë u distribuuan 1.222 pako higjienike, 5.704 pako ushqimore, 32.704 vakte të ngrohta, u kryen 35.097 intervenime për ofrimin e ndihmës së parë, u asistuan 21.911 persona dhe 3.675 persona u akomoduan në Qendrat e pritjes “Vinojug” në Gjevgjeli dhe Tabanoc në Kumanovë. Si prioritet të rëndësishme të ekipeve të Kryqit të kuq ishte ofrimi i asistencës mjekësore dhe humanitare për migruesit dhe refugjatët në Qendrat e pritjes “Vinojug” dhe Tabanoc, ulja e prekshmërisë së foshnjave dhe fëmijëve, nënave dhe të moshuarve, asistencë mjekësore dhe humanitare për migruesit e parregullt dhe refugjatët, forcimi i aktiviteteve të koordinuara me të gjitha institucionet qeveritare në terren.

Mbështetja për popullsinë e prekur nga zjarret në Greqi

Zjarret që kapluan zonën e qytetit të Athinës në Greqi shkaktuan dëme të mëdha materiale dhe për fat të keq viktima njerëzore. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në vazhdimësi ndoqi situatën dhe në përputhje me udhëzimet e marra nga ana e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe veproni në mënyrë përkatëse. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë menjëherë u përfshi në aksionin për të ndihmuar popullsinë e prekur duke përgatitur një thirrje për grumbullimin e fondeve. Nga donacionet e telefonave celularë u mbledhën fonde në shumë prej 153.800,00 denarë, ndërkaq nga subjektet juridike dhe nga pagesa e mjeteve financiare nga qytetarët u mbledhën 3.191.900,00 denarë.



Siguria në ujë

Në vitin 2018 u mbajtën kurse për trajnimin e shpëtimtarëve të ujit si më poshtë:

- Një kurs i trajnimit të shpëtimtarëve të ujërave të hapura në Ohër dedikuar nevojave të ARM-së ku morën pjesë 20 kandidatë.
- Pesë kurse të shpëtimit të ujërave të mbyllura dhe akua-parqeve me gjithsej 31 kandidatë prej të cilëve 23 kandidatë e dhanë provimin.
- Një kurs i trajnimit të shpëtimtarëve të ujërave të hapura ku morën pjesë 12 kandidatë.

Në përputhje me Plan-programin e parashikuar të Qendrave të Sigurisë në Ujë në Kryqin e kuq Ohër dhe Shkup për vitin 2018, përgjithësisht u realizuan të gjitha aktivitetet dhe detyrat e projektuara të cilat para së gjithash ishin të përqendruara në përgatitjen dhe angazhimin e shpëtimtarëve të ujit në zonat e larjes, pishina, akua-parqe dhe sigurimin e aktiviteteve sportive të ujit.

Qendra e sigurisë së ujërave të hapura – Ohër

Në periudhën 01.07.2017 - 31.08.2017, u regjistrua një angazhim profesional i anëtarëve të Qendrës së sigurisë së ujit të Kryqit të kuq - Ohër me gjithsej 22 zona të organizuara të larjes dhe rekreacionit të bregut të Liqenit të Ohrit dhe 2 pishina, 5 zona të larjes së bregut të Strugës dhe 1 akua-park, 4 zona të larjes së bregut të Liqenit të Prespës, 1 pishinë në Negotinë dhe 1 zonë e larjes në bregun e Liqenit të Dibrës. Për një siguri maksimale të të gjithë vizitorëve dhe notarëve të zonave të organizuara të larjes në Liqenin e Ohrit, Prespës dhe Dibrës profesionalisht u angazhuan 80 shpëtimtarë të rinj të ujit dhe shpëtimtarë të ujit. Në përputhje me evidencat (raportet/procesverbalet) e përditshme deri më 15.09.2018 u regjistruan gjithsej 1864 intervenime.

Qendra e sigurisë së ujërave të mbyllura – Shkup

Në periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018, Qendra e sigurisë së ujit e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit organizoi aktivitete në 7 zona të organizuara të larjes dhe rekreacionit, 6 pishina dhe 1 akua-park. U angazhuan 46 shpëtimtarë të ujit. Në përputhje me evidencat e përditshme zyrtare (raportet/procesverbalet) në vitin 2018 u regjistruan 182 intervenime në pishina dhe 937 intervenime në Akua-parkun në Shkup.



SHËRBIMI PËR KËRKESA – RIVENDOSJA E LIDHJEVE FAMILJARE

Në vitin kalendarik migrimet edhe më tej ishin në qendër të vëmendjes së shoqatave nacionale të Kryqit të kuq/Gjysmëhënës së kuqe në Evropë me theks në sigurimin e mbështetjes për përmbushjen e nevojave parësore të kësaj popullsie, ndër të cilat edhe aktivitetet e rivendosjes së lidhjeve familjare. Aktivitetet në këtë fushë u realizuan në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën rajonale të Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq të Beogradit. Shërbimi për kërkesa dhe rivendosjen e lidhjeve familjare i Kryqit të kuq të RM-së realizoi një sërë rezultatesh pozitive vitin e kaluar që janë një bazë e mirë për përparimin e mëtejshëm të punës në këtë fushë.

Konferenca Vjetore kushtuar rivendosjes së lidhjeve familjare

Në periudhën nga 13 deri më 16 mars në Zagreb u mbajt Konferenca Vjetore kushtuar rivendosjes së lidhjeve familjare dhe një punëtori për mbrojtjen e të dhënave, organizuar nga Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq dhe Kryqi i kuq i Kroacisë. Në këtë konferencë theksi u vu në zhvillimin e Strategjisë së Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në kontekst të ripërtëritjes së lidhjeve familjare, lidhjen e familjeve të ndara në situata të krizës, por edhe në kërkimin e personave të zhdukur në Luftën e Dytë Botërore, një temë që akoma është aktuale në shërbimet për kërkesa të shoqatave nacionale. Në konferencën në të cilën morën pjesë përafërsisht 150 përfaqësues të 46 shoqatave nacionale të botës, ndër të cilat edhe Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, u bisedua gjithashtu për implikimet e Rregullores së Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave mbi Lëvizjen e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në përputhje me Rregulloren e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave që hyn në fuqi në maj të vitit 2018. Kjo konferencë u dha një mundësi të pranishmëve për të identifikuar sfidat potenciale dhe harmonizimin e procedurave me dispozitat e reja.

Bashkëpunimi me Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të kuq

Në periudhën 28 - 29 maj, Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë e vizitoi një delegacion katër-anëtarësh i Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq. Delegacionin e KNKK-së e kryesonte Gordana Milenković – zëvendës-shefe e delegacionit të KNKK-Beograd. Qëllimi i vizitës ishte monitorimi i aktiviteteve të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë të cilat i realizon në bashkëpunim me Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të kuq. Në pjesën e diseminimit përfaqësuesit e KNKK-së u informuan për dy trajnimet e zbatuara të diseminuesve dhe për aktivitetet e diseminuesve në organizatat komunale të Kryqit të kuq, si dhe për bashkëpunimin me ARM-në në vitin 2018 lidhur me trajnimet e diseminimit për të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe punën e komponentëve të Lëvizjes. Përfaqësuesit e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq sugjeruan përgatitjen e një plani veprimi për vitin e ardhshëm ku do të shënohen aktivitetet e planifikuara për të cilat nevojitet mbështetja e Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq për vitin 2019. Gjithashtu u diskutua puna e shoqatës nacionale në fushën e shërbimit për kërkesa me theks në nevojën për të bërë një trajnim përkatës për rivendosjen e lidhjeve familjare në shoqatën nacionale.



Trajnimi për mbrojtjen dhe rivendosjen e lidhjeve familjare

Në kuadër të projektit të mbrojtjes, mbështetur nga Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq, më 31 tetor dhe më 01 nëntor të vitit 2018, në Strugë u mbajt një trajnim dedikuar ngritjes së kapaciteteve me temën mbrojtja dhe rivendosja e lidhjeve familjare. Trajnimi u mbajt në bashkëpunim me Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të kuq dhe iu dedikua anëtarëve të ekipeve të lëvizshme të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë që punojnë në qendrat e pritjes në Tabanoc dhe Gjevgjeli dhe në zonat kufitare. Në këtë punëtori ishin të pranishëm 21 pjesëmarrës të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe katër përfaqësues të Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq. Përmbajtjet që u përpunuan në këtë punëtori ishin: korniza e përgjithshme ligjore e mbrojtjes, puna e Kryqit të kuq të RM-së në fushën e mbrojtjes dhe puna me personat e parburgosur, rivendosja e lidhjeve familjare, marrëdhëniet me personat e parburgosur etj. Në punëtori gjithashtu u përpunuan dy raste studimore për situatat reale të lidhura me shërbimet për kërkesa dhe rivendosjen e lidhjeve familjare të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në terren.

Takimi rajonal me temë – Rivendosja e lidhjeve familjare

Në periudhën nga 12 deri më 15 nëntor në Beograd u mbajt Takimi i katërt rajonal i shoqatave nacionale që janë pjesë e Qendrës Rajonale Informative, i koordinuar nga ana e Zyrës së Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq në Beograd. Përfaqësuesit e shoqatave nacionale të Serbisë, Maqedonisë, Kroacisë, Sllovenisë, Bosnjë e Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Rumanisë, Hungarisë dhe Shqipërisë gjatë takimit biseduan për tema të ndryshmet të lidhura me krizën migruese dhe aktivitetet për rivendosjen e lidhjeve familjare. Shoqatat nacionale patën prezantimet e tyre për krizën migruese, me theks në rivendosjen e lidhjeve familjare. Nga temat që u diskutuan në këtë takim, vëmendja më e madhe ndoshta iu kushtua risive që Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq i sjell në pjesën e dokumenteve emergjente të udhëtimit me rastin e bashkimit të familjeve në mes dy shteteve, aktivitetet me familjet anëtarët e së cilave luftojnë në ushtri të huaja, shërbimi për kërkesa si pjesë e programit të mbrojtjes, futja e një baze të të dhënave, risitë në përdorimin e ueb-faqes për rivendosjen e lidhjeve familjare të Komitetit ndërkombëtar të Kryqit të kuq dhe përgatitja e Strategjisë së re të Lëvizjes për rivendosjen e lidhjeve familjare.



VEPRIMTARIA SOCIALE-HUMANITARE

Programi i asistencës personale për personat me aftësi të kufizuara

Me iniciativën e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë u përfshi në zhvillimin e programit të asistencës personale për personat me aftësi të kufizuara i cili u zbatua gjatë vitit 2018. Programi i asistencës personale për personat me aftësi të kufizuara synon të kontribuojë në jetesën e pavarur të personave me aftësi të kufizuar dhe pjesëmarrjen e tyre aktive dhe të barabartë në komunitet dhe në shoqëri në tërësi. Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim me Shoqatën "Humanost" përgatiti një program për trajnimin e asistentëve personalë për personat me aftësi të kufizuara që u verifikua nga ana e Qendrës së Arsimit për të Moshuarit. U zbatuan trajnime të asistencës personale për personat me aftësi të kufizuara dhe për këtë qëllim u formuan shtatë ekipe të trajnerëve të përbërë nga: një punonjës social, një defektolog, një mjek dhe një infermiere.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë më 10 maj të vitit 2018 filloi zbatimin e trajnimit të asistentëve personalë për personat me aftësi të kufizuara, i mbështetur nga ana e Agjencisë së Punësimit të RM-së. Trajnimi u ndoq nga 96 persona prej të cilëve 5 persona u përfshinë me mbështetjen e Organizatës komunale të Kryqit të kuq - Strumicë. Trajnimet u zbatuan në Shkup, Manastir, Strugë, Strumicë, Gostivar, Negotinë dhe Kumanovë.

Më 16 korrik të vitit 2018 në një ngjarje solemne në Qeverinë e RM-së, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ndau certifikata për asistentët e trajnuar personalë.

Nga muaji korrik e deri në fund të vitit u zbatua procesi i ofrimit të shërbimeve për 51 përfitues, për çka u angazhuan 48 asistentë personalë.

Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit në periudhën tetor-dhjetor të vitit 2018 zbatoi një trajnim shtesë të asistencës personale për personat me aftësi të kufizuara ku u përfshinë gjithsej 19 persona.

Kujdesi dhe mbështetja për të moshuarit

Kryqi i kuq i RM-së gjatë vitit 2018 vazhdoi implementimin e Projektit kujdesi për të moshuarit në shtëpi, i mbështetur nga qytetit i Shkupit dhe Fondacioni Albiz edhe Shparkasse banka nëpërmjet Kryqit të kuq të Austrisë. U angazhuan gjithsej 12 vullnetarë të Kryqit të kuq dhe 6 infermiere që vazhdimisht ofruan shërbime sociale dhe shëndetësore për gjithsej 178 të moshuar në shtëpi.

Përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit në vazhdimësi vijoi implementimi i aktiviteteve programore për të moshuarit në qendrat ditore të personave të moshuar dhe në qendrat e ofrimit

të ndihmës në shtëpi me lokale në SHOH "Dare Xhambaz", në Organizatën komunale të Kryqit të kuq – Çair, si dhe në ambientet e SHF në Komunën e Sarajit. Aktivitetet që u organizuan përmes Qendrës ditore në Gazi Babë, gjithashtu u zbatuan në vazhdimësi edhe gjatë vitit.

Në bazë mujore mesatarisht frekuentimi i qendrave ditore në numra është si më poshtë:

Qendra ditore SHOH "Dare Xhambaz" 330 persona, Qendra ditore OK Çair 170 persona, Qendra ditore Saraj 190 persona dhe Qendra ditore Gazi Babë 250 persona.

Klubet e të moshuarve që funksionojnë përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq Kriva Palankë, Negotinë dhe Prilep, edhe gjatë vitit vazhduan të kryejnë implementimin e aktiviteteve përkatëse me të moshuarit.

Nga 27 deri më 30 gusht të vitit 2018 u realizua një vizitë e Kryqit të kuq të Zvicrës në Bernë me qëllim të shkëmbimit të përvojave për vendosjen dhe zhvillimin e një programi të intervenimit emergjent për të moshuarit e vetmuar. Përvojat pozitive nga ana e Kryqit të kuq të Zvicrës do të vihen në funksion për themelimin e një sistemi të lajmërimit emergjent i cili si projekt pilot do të realizohet përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit.

Në përputhje me programin e verifikuar të trajnimit të kujdestareve për personat e moshuar dhe të pafuqishëm gjatë vitit 2018 përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit u zbatuan 2 trajnime. Numri i përgjithshëm i kujdestareve që përfunduan trajnimin është 26 dhe ato shërbyen 15 të moshuar me një kujdes falas në kohëzgjatje prej 2 muaj. Gjithsej numri i kujdestareve që u angazhuan në vitin 2018 është 18 veta. Ato shërbyen 22 përfitues në shtëpi. Tri kujdestare u trajnuan në mënyrë shtesë për ndihmë të avancuar mjekësore, dhe 6 u dërguan në shtator në vizitë studimore në Nyrnberg, Gjermani në edukim shtesë.



Dita ndërkombëtare e të moshuarve

Me rastin e shënimit të Ditës ndërkombëtare së të moshuarve, përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatave komunale të Kryqit të kuq u organizuan punëtori edukative në tema me interes për qytetarët e moshuar, aktivitete kreative, rekreative dhe aktivitete të tjera përkatëse të lidhura me plakjen aktive, si dhe aktivitete për mbështetjen dhe kujdesin e të moshuarve.

Kombet e Bashkuara, Ditën ndërkombëtare të të moshuarve e shënuan në shenjë të festimit të rëndësishëm të 70-vjetorit të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut dhe konfirmuan përkushtimin drejt promovimit të gëzimit të plotë dhe të barabartë të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirisë fundamentale të personave të moshuar. Më 1 tetor të vitit 2018 në Qendrën ditore për të moshuar të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit u mbajt një punëtori edukative me anëtarët e kësaj qendre në temën: "Hyrje në plakjen dhe të drejtat e njeriut të personave të moshuar."

Java e kujdesit për të moshuarit

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë nga 19 deri më 25 nëntor të vitit 2018 shënoi "Javën e kujdesit për të moshuarit" me moton: "Të gjithë ne jemi fëmijët e tyre". Qëllimi i shënimit të Javës ishte rritja e ndërgjegjes publike për nevojën e një integrimi të rritur të personave të moshuar në të gjitha sferat e jetës shoqërore, si dhe nevojën e sigurimit të kujdesit dhe ndihmës për të moshuarit. Në kuadër të Projektit rajonal "Marrja e aksionit për përfshirjen sociale të personave të moshuar", financuar nga Bashkimi Evropian, u siguroa mbështetja për shënimin e Javës, për çka u përgatitën materiale me përmbajtje të përshtatshme për informimin e të moshuarve për të drejtat e tyre rreth mbrojtjes sociale dhe shëndetësore. Këtë vit përveç anëtarëve të rrjetit "InkluzivaM", në shënimin e Javës u përfshinë edhe gjashtë shoqata të qytetarëve përfitues të nën-granteve që kanë kryer implementimin e projekteve për përfshirjen sociale të personave të moshuar.

Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim me Shoqatën "Humanost" më 19 nëntor të vitit 2018 organizoi një punëtori me përfaqësuesit e mediave me qëllim të njohjes së tyre me temat e rëndësishme për të moshuarit, tema që janë përfshirë përmes anëtarëve të rrjetit "InkluzivaM". Gjatë Javës përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq, Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, si dhe anëtarët e "InkluzivaM" dhe shoqata të tjera, u përfshinë gjithsej 4.665 të moshuar përmes aktiviteteve të ndryshme: aksion për matjen falas të nivelit të sheqerit në gjak dhe të shtypjes së gjakut për të moshuarit, punë-

tori me përfaqësues të institucioneve qeveritare, sektori civil dhe privat për inkurajimin e aktiviteteve për plakjen aktive, vizita të moshuarve të vetmuar dhe të pafuqishëm në shtëpitë e tyre, duke përfshirë vullnetarë të rinj të Kryqit të kuq dhe punonjës shëndetësorë (kontrolle falas, ofrim të ndihmës etj.), punëtori edukative në tema me interes për të moshuarit, punëtori kreative, aktivitete rekreative, aktivitete humanitare duke përfshirë persona aktivë të moshës së tretë, gara sportive, takime ndërmjet gjeneratave dhe shoqërime, si dhe punëtori tematike për inkurajimin e përfshirjes sociale të personave të moshuar. Për implementimin e aktiviteteve u angazhuan gjithsej 536 vullnetarë.



Bashkëpunimi rajonal për përfshirjen sociale të personave të moshuar

Nga muaji shkurt i vitit 2016 nisi implementimi i projektit rajonal "Marrja e aktiviteteve për përfshirjen sociale të personave të moshuar", financuar nga Bashkimi Evropian, implementimi i të cilit u krye në periudhë prej tre vjetësh përmes Kryqit të kuq të Serbisë, si projekt-koordinator në partneritet me Kryqin e kuq të Austrisë, Kryqin e kuq të Maqedonisë, Shoqatën qytetare "Humanost" nga Maqedonia, Kryqin e kuq të Malit të Zi dhe shoqatat qytetare të Shqipërisë dhe Bosnjë e Hercegovinës. Qëllimi i Projektit ishte krijimi i rrjeteve rajonale të shoqatave qytetare dhe organizatave të Kryqit të kuq në pesë vende të Ballkanit Perëndimor, që do të kryejnë implementimin e aktiviteteve për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe ndikimet pasuese në proceset e vendimmarrjes për përfshirjen sociale të personave të moshuar. Qëllimi i projektit ishte formimi i rrjeteve rajonale të shoqatave civile dhe organizatave të Kryqit të kuq në pesë vende të Ballkanit Perëndimor, që do të bëjnë implementimin e aktiviteteve për të rritur ndërgjegjësimin e publikut dhe ndikimet pasuese në procesin e vendimmarrjes për përfshirjen sociale të personave të moshuar. Në takimin nacional

të rrjetit të organizatave qytetare për përfshirjen sociale të personave të moshuar, ku u nënshkrua vendimi për funksionimin zyrtar të rrjetit joformal "InkluzivaM", u përgatit gjithashtu një plan strategjik i punës së rrjetit për periudhën prej tre vjetësh, në bazë të analizës së përgatitur për situatën në Maqedoni që përfshiu informacione për palët e interesuara relevante, mangësitë e politikave, shërbimet dhe nevojat e të moshuarve, si dhe kapacitetet e sektorit civil për zbatimin e aktiviteteve për avokimin e përfshirjes sociale të personave të moshuar.

Në rrjetin "InkluzivaM" përveç Kryqit të kuq të RM-së dhe Shoqatës "Humanost" anëtarësojnë shoqatat civile si vijon: Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të RM-së, Universiteti Mosha e Tretë, Shoqata "Justicia", Shoqata e Sëmundjes Alzhajmer, Agjencia Lokale e Ndihmës, Shoqata "Sumnal" dhe Organizata e Grave të Komunës Pehçevë.

Me mbështetjen e një agjencie të jashtme të hulumtimit u zbatua një hulumtim që siguroi të dhëna dhe prova për nevojën e hapjes së serviseve për shërbime sociale dhe shëndetësore për të moshuarit, me qëllim të ndikimit në vendimmarrjen e institucioneve qeveritare rreth nevojës dhe zhvillimit të llojit të tillë të serviseve. Për të marrë një transparencë u zhvillua një diskutim paneli ku u prezantuan rezultatet e hulumtimit.

Në punën e rrjetit u siguroa bashkëpunimi dhe mbështetja e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Entit të Veprimtarisë Sociale, Qytetit të Shkupit, Institutit të Shëndetit Publik, Institutit të Punës Sociale dhe Politikës Sociale dhe UNFPA.

Në kuadër të projektit rajonal u mbështetën gjithsej 12 shoqata civile për implementimin e projekteve të vogla të përfshirjes së personave të moshuar, që u realizuan në periudhën prej 10 muajsh deri në gusht të vitit 2018.

Nga 10 deri më 12 gusht të vitit 2018 në Qendrën "Solferino" në Strugë u mbajt takimi nacional i rrjetit "InkluzivaM". Qëllimi i punëtorisë ishte përgatitja e Planit strategjik të avokimit gjatë hapjes së serviseve për të moshuarit. Bazë e përgatitjes së strategjisë ishin rezultatet e hulumtimit lidhur me nevojën e serviseve të shërbimeve sociale dhe shëndetësore për të moshuarit, që u zbatua gjatë vitit të kaluar.

Gjatë shtatorit dhe tetorit të vitit 2018, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Shoqatën "Humanost" mbajtën gjashtëmbëdhjetë punëtori edukative ku u përfshinë 100 qytetarë – të moshuar të komuniteteve të Shkupit, Kriva Pallankës, Kumanovës, Manastirit, Prilepit, Strugës, Ohrit, Gostivarit, Velesit, Kërçovës, Radovishit, Negotinës, Vinicës, Makedonska Kamenicës dhe Pehçevës.

Nga 30.11 deri më 02.12. të vitit 2018 në Strugë u mbajt punëtorja edukative për përgatitjen e projekteve të BE-së. Qëllimi i punëtorisë ishte që anëtarët e rrjetit "InkluzivaM" të përfshirjes sociale të personave

të moshuar të njihen me projektet dhe përgatitjen e tyre për të aplikuar në fondet e Bashkimit Evropian.

Më 11 dhe 12 dhjetor të vitit 2018 në Beograd u zhvillua Konferenca rajonale organizuar nga Kryqi i kuq i Serbisë. Qëllimi i mbajtjes së konferencës ishte rumbullakimi i implementimit trevjeçar të aktiviteteve të projektit në pesë vendet. Në konferencë u prezantuan rezultatet e zbatimit të aktiviteteve të projektit në Maqedoni dhe praktikatat pozitive të realizimit të projekteve të vogla për përfshirjen sociale të personave të moshuar në komunitete.



Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Entin e Veprimtarisë Sociale tanimë shumë vjet në vazhdimësi bën implementimin e iniciativave të përbashkëta për përmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara.

Gjatë muajit janar të vitit 2018 u nënshkrua një marrëveshje donacioni me Bankën Komerciale SHA Shkup, kompani kjo që tanimë tetë vjet në vazhdimësi mbështet aktivitetet e projektit që zbatohen përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq Prilep, Kavadar, Gostivar, Veles, Dellçevë, Dibër dhe Kërçovë, në bashkëpunim me qendrat ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe qendrat e punës sociale.

Në kuadër të projektit "Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara" më 20 shkurt të vitit 2018 u zhvillua një punëtori informative me përfaqësues të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe qendrat ditore ku u dhanë udhëzime për implementimin e aktiviteteve gjatë vitit.

Nga 9 deri më 11 mars të vitit 2018 në Strugë u zhvillua një punëtori edukative me vullnetarët e

rinj të organizatave të Kryqit të kuq dhe qendrave ditore, ku u shqyrtuan dhe miratuan planet lokale të veprimit. Qëllimi i punëtorisë ishte të pajisurit e vullnetarëve me njohuri dhe shkathtësi të caktuara për t'ju qasur dhe mbështetur fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara. Në punëtori u prezantua loja paraolimpike për personat me aftësi të kufizuara "Boçia".

Në kuadër të shënimit të Javës së Kryqit të kuq të RM-së, më 9 maj të vitit 2018 në sheshin "Maqedonia" në Shkup u mbajt një ngjarje ku u organizua një garë sportive humanitare e lojës "Boçia" në të cilën morën pjesë fëmijët e qendrave ditore të Shkupit, Prilepit, Kavadarit, Gostivarit, Velesit, Dellçevës, Dibrës dhe Kërçovës.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë më 06 dhjetor të vitit 2018 organizoi një punëtori për evalvimin e aktiviteteve të projektit. Qëllimi i punëtorisë ishte verifikimi i rezultateve të arritura, efektet e aktiviteteve të zbatuara, si dhe dhënia e udhëzimeve për veprimin e ardhshëm në nivel lokal.

Zhvillimi i përbashkët i komunitetit

Projekti "Zhvillimi i përbashkët i komunitetit" – ZHPK, është një metodë e punës që kontribuon në kuptimin më të mirë të prekmërisë, ndihmon në identifikimin e kapaciteteve lokale dhe mundësinë për të ndërtuar partneritet me personat e prekmërisë, institucionet qeveritare, pushtetin lokal, organizatat joqeveritare, komunitetin e biznesit, përmirësimin e jetës së popullsisë së prekmërisë. Me mbështetjen e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe vazhdoi implementimi i Projektit ZHPK gjatë vitit 2018 në dy organizata komunale të Kryqit të kuq, Negotinë dhe Qendër.

Në përputhje me udhëzimet u formuan ekipe të përbëra nga përfaqësues të organizatave komunale të Kryqit të kuq, institucionet qeveritare, pushteti lokal, sektori civil dhe përfaqësues të komuniteteve të prekmërisë. Gjatë muajit janar u përgatitën analizat e vlerësimit të shpejtë të përbashkët të nevojave që u zbatuan në dy komunitete të prekmërisë. U organizuan punëtori në një grup të madh me popullsinë e komuniteteve për të përcaktuar çështjet parësore për përmbushjen e nevojave të komuniteteve.

Në bazë të analizave të përgatitura nga vlerësimi i përbashkët i shpejtë i nevojave që u zbatua në dy komunitete të prekmërisë (në Shkup – komuniteti në Rr. "Samoillova" dhe në Negotinë – komuniteti në f. Krivollak) dhe nevojat e përcaktuara parësore të komuniteteve, u përgatitën dy mikro-projekte për përmbushjen e nevojave. Aktivitetet e projektit u zbatuan gjatë muajit maj dhe qershor. Në komunitetin "Samoillova" u zbatua projekti për krijimin e

një këndi për përmirësimin e jetës sociale të popullsisë në Rr. "Samoillova", ndërsa në komunitetin në f. Krivollak në Negotinë, u zbatua një projekt për përfundimin e arsimit fillor të 20 personave mbi 16 vjeç të popullsisë rome.



Një sistem më efikas i distribucionit të veshjeve

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë – Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit si rezultat i punës shumëvjeçare në fushën e dhurimit të veshjeve dhe distribucionin e tyre tek më të prekurit, nga muaji maj i vitit 2018 filloi implementimin e projektit "Kop-sa". Qëllimi i projektit ishte të mundësojë një sistem më efikas të distribucionit të veshjeve për personat në rrezik, një qasje të lehtë tek veshjet me çmime të ulëta për gjithë qytetarët për të ruajtur dinjitetin e atyre që kanë të ardhura të ulëta dhe që nuk kërkojnë ndihmë, punësimi i grupeve të synuara të prekura dhe kontributi në ruajtjen e mjedisit jetësor. Në "Kopsën" përveç qytetarëve që dhurojnë dhe qytetarët që blejnë veshje, paralelisht realizohen aktivitete për distribucionin falas të veshjeve për personat më të prekur. Në procesin e përzgjedhjes, përgatitjes dhe shitjes së veshjeve janë përfshirë dy persona të projektit për ri-integrimin në punë të personave të pas-trehë dhe dy persona vullnetarë. Në muajin tetor dhe

nëntor u zbatua trajnimi për qepjen dhe përpunimin e produkteve me teknikën “paçvork”. Produktet janë përpunuar nga veshjet e dhuruara që nuk mund të përdoren drejtpërsëdrejti. Kryqi i kuq i RM-së në përfundim të punës do të iniciojë zhvillimin e këtij modeli edhe në mjedise të tjera.

Qendra e të pastrehëve

Qendra e të pastrehëve e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit gjatë gjithë vitit punoi çdo të premte dhe u vizitua nga të pastrehët të cilët aty patën mundësinë për të marrë këto shërbime: larje, shërbime floktarie, rroba të pastra, kontroll mjekësor dhe barna falas, bisedë me punonjës social dhe psikologun, dhe një vakt. Ajo vizitohet rregullisht nga 65 të pastrehë, dhe të premtën janë të pranishëm mesatarisht 45 të pastrehë. Përveç qendrës në Shkup funksionojnë edhe qendrat rajonale në Strumicë, Manastir dhe Strugë të cilat u lejojnë të pastrehëve për të marrë kujdesin dhe ndihmën e duhur, veçanërisht kur jashtë temperaturat e motit janë të ulëta.

gjithsej 8.847 kg. ushqim, 14.184 kg. rroba, 900 palë këpucë, dhe të holla në shumë prej 362.196 denarë të cilat u dedikuan për sigurimin e ndihmës ushqimore. Në aksion u angazhuan gjithsej 680 vullnetarë të Kryqit të kuq. Ndihma e siguruar humanitare u shpërnda tek gjithsej 1.425 persona në rrezik social.

Fushata me rastin e Ditës së urisë

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë me rastin e 16 tetorit – Ditës së urisë, organizoi një fushatë me moton “Mendoni edhe për ne”. Me këtë fushatë dhe me shumë aktivitete të tjera humanitare, Kryqi i kuq i RM-së kontribuon në përpjekjet e përgjithshme të ndërmarra në vendin tonë për reduktimin e varfërisë dhe përjashtimit social të qytetarëve, si një nga qëllimet kryesore të strategjisë, një dokument që pasqyron intencën e Republikës së Maqedonisë për të barazuar shkallën e përfshirjes dhe mirëqenies në të gjitha shtresat e shoqërisë.

Në kuadër të fushatës u organizuan aksione humanitare për sigurimin e donacioneve në të holla dhe ushqim në bashkëpunim me institucionet arsimore-edukuese, shoqatat civile, odat ekonomike në Maqedoni, nga mbështetja e kompanive dhe qytetarëve. Në implementimin e këtyre aktiviteteve u përfshinë 1309 vullnetarë të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Në fushatë u siguruan mjete në shumë prej 785.556 denarë, 16.540 kg. produkte ushqimore dhe ndihma u shpërnda tek 1.928 persona në rrezik social.



Kontributi juaj – ndihmë e rëndësishme

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë me moton: “Kontributi juaj – ndihmë e rëndësishme” nga 16 deri më 22 prill të vitit 2018 me aktivitete të përshtatshme shënoi “Javën e solidaritetit” që është tradicionale. Në kuadër të Javës u organizua Aksion grumbullimi për dhurimin e ushqimit, veshmbathjeve, mjeteve higjienike me qëllim të zgjimit të ndjenjës së humanitetit, reciprocitetit dhe solidaritetit tek qytetarët, veçanërisht tek gjenerata e re për ndihmën dhe mbështetjen e ndërsjellë. Gjatë Javës u zbatua aksioni “Nga shtëpia në shtëpi” ku vullnetarët e organizatave komunale të Kryqit të kuq vizituan qytetarët në shtëpitë e tyre, të cilët nga ana tjetër dhuruan mjete sipas dëshirës dhe mundësisë së tyre. Paratë e grumbulluara nga aksioni u dedikuan për sigurimin e ndihmës ushqimore për familjet në rrezik social. Në aksionet humanitare u siguruan



Aksioni humanitar “Ushqe 10.000”

Me iniciativën e Shoqatës “Eja Maqedoni”, Kryqi i kuq i RM-së u përfshi në ngjarjen donatore “Ushqe 10.000” – një aksion nacional i dhurimit të ushqimit në lokacione të caktuara dhe shpërndarja e tyre tek qytetarët e rrezikuar në aspektin social. Qëllimi i aksionit ishte grumbullimi i 10 tonëve ushqim një herë në muaj që do të përfundojë në duart e 10.000 qytetarëve. Ngjarja e parë u mbajt më 6 shtator të vitit 2018 në Shkup, Manastir, Kumanovë, Prilep, Strumicë, Radovish, Gjevgjeli, Gostivar, Koçanë dhe Vinicë, ku u siguruan 2.962 kg. produkte ushqimore. Aksioni i dytë u organizua më 16 tetor të vitit 2018 në kuadër të fushatës për Ditën e urisë.

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë si anëtar i Sekretariatit të Komisionit nacional për luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit ilegal, edhe këtë vit u përfshi në shënimin e 18 tetorit – Ditës evropiane të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Me këtë rast u organizuan punëtori të edukimit të bashkëmohatarëve për të rinjtë e shkollave fillore dhe të mesme që u zbatuan përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq Qendër, Karposh, Kisella Vodë, Ohër Veles, Prilep, Krushevë, Resnjë, Berovë, Radovish, Gjevgjeli, Kavadar, Koçanë, Strugë, Dibër, Makedonski Brod, Tetovë, Demir Hisar, Gostivar. Leksionet e parandalimit kishin për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të të rinjve, njohjen e mënyrave përmes së cilave të rinjtë mund të përfshihen në trafikimin e qenieve njerëzore dhe vetëmbrojtja e tyre. Përmes 25 punëtorive edukative u përshinë mbi 600 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe vullnetarë dhe punonjës të Kryqit të kuq. Me rastin e Ditës, ekipi i lëvizshëm i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit në Likovë organizoi një marshim njëditor së bashku me popullsinë lokale të f. Llojan dhe f. Vaksincë, si dhe me përfaqësues të MPB-së – Policia kufitare veri, OJQ “Legis” dhe OJQ “Zhvillimi qytetar” për të rritur ndërgjegjësimin ndaj këtij lloji të “skllavërisë moderne”.

Në kuadër të avancimit të veglave dhe formave ekzistuese të edukimit për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore tek të rinjtë, dy përfaqësues të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë morën pjesë në punëtorinë me temë “Trafikimi i qenieve njerëzore me theks në migruesit” që u realizua në periudhën nga 3 deri më 6 korrik në Ankara, R. e Turqisë, mbështetur nga Federata ndërkombëtare e shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Gjysmëhënës së kuqe të Turqisë. Në këtë punëtori u prezantua dhe u përpunua doracak i ri për trafikimin e qenieve njerëzore me qëllim të unifikimit

të punës së shoqatave nacionale në implementimin e programeve të parandalimit. Pas kësaj punëtorie, shoqata jonë nacionale mori mbështetjen për implementimin e një projekti në temën “Parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore, në kontekst të migrimeve”. Në kuadër të projekti në periudhën 13-15 shtator, Kryqi i kuq i RM-së realizoi një punëtori për trajnimin e edukatorëve të bashkëmohatarëve në këtë temë, u përgatitën dhe u publikuan flajerë informativë dhe edukativë. U trajnuan 23 vullnetarë të rinj të 11 organizatave komunale të Kryqit të kuq, përfaqësues të ekipeve të lëvizshme në Likovë dhe Vinojug. Në punëtorinë në terren u përfshinë gjithsej 210 përfaqësues të vetëqeverisjeve lokale dhe shkollave, si dhe 844 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme. Nga fundi i vitit u siguroa mbështetja nga Agjencia e Rinisë dhe Sportit për aktivitetet në vitin 2019 në tri OKKK të reja.



Pushim dhe rekreacion për fëmijët e familjeve në rrezik social dhe fëmijët përfitues të shtesës së veçantë

Ministria e punës dhe Politikës Sociale gjatë periudhës së dimrit nga 02 deri më 22 janar të vitit 2018 organizoi një pushim dhe rekreacion falas për fëmijët e familjeve në rrezik social, fëmijët përfitues të shtesës së veçantë dhe të së drejtave të tjera, në pushimoren “Begova Korija” në Krushevë. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë u përfshi në këtë aktivitet të projektit duke angazhuar vullnetarë të Kryqit të kuq në rolin e edukatorëve për të animuar fëmijët gjatë qëndrimit të tyre të organizuar në katër grupe. Vullnetarët përgatitën programe me aktivitete edukative, rekreative, kreative të cilat i zbatuan me fëmijët gjatë qëndrimit të tyre në Krushevë.

Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Ministrisë këtë projekt e zbatoi gjatë periudhës së verës. Vullnetarët e angazhuar – edukatorët/bashkëpunëtorët profesionalë dhe shpëtimtarët e ujit të organizatave komunale të Kryqit të kuq edhe gjatë muajve korrik dhe gusht realizuan aktivitete me fëmijët në pushimoren e fëmijëve “Majski Cvet” në Strugë.

VEPRIMTARIA PARANDALUESE SHËNDETËSORE

Reduktimi i dëmeve nga përdorimi i drogës

Reduktimi i dëmeve nga përdorimi i drogës është një projekt dedikuar për personat – përdorues të drogës dhe zhvillohet në territorin e tri organizatave komunale të Kryqit të kuq Kërçovë, Veles dhe Prilep. Qendrat e hapura në organizatat komunale kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve mjekësore, sociale dhe juridike për përdoruesit si dhe furnizimin e tyre me prezervativë dhe pajisje sterile të injektimit. Qëllimi i projektit është reduktimi i dëmeve nga përdorimi i drogës në drejtim të përmirësimit të statusit shëndetësor, social dhe ekonomik të përdoruesve. Përdoruesit e drogave kanë mundësinë për të marrë pajisje sterile të injektimit dhe këshillime rreth dëmeve të mundshme të shkaktuara nga përdorimi i pajisjes jo sterile, siç janë HIV/SIDA dhe Hepatiti B dhe C.

Në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik dhe OJQ "HERA" u zhvillua një këshillim i besueshëm dhe një testim në terren në Prilep dhe Veles.

U përfshinë 631 persona të popullsisë së synuar. Për të kontribuar në risocializimin e klientëve u realizuan punëtori kreative me tematikë të ndryshme varësisht nga nevojat dhe dëshirat e tyre, si për shembull përpunimi i stolive, përpunimi i fotografive me tematikë të ndryshme, gjësende të materialeve të ndryshme etj.

Shënimi i Ditës botërore të luftës kundër tuberkulozit, 24 marsi

Kryqi i kuq i R. së Maqedonisë shënoi Ditën botërore të luftës kundër TB-së me moton Ti mund ta bësh historinë. Ndaloje TB-në!

Organizatave komunale dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit zbatuan aktivitete në kuadër të mundësive të tyre me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit së publikut dhe njohurive për këtë sëmundje.

Shënimi i Javës së luftës kundër tuberkulozit, 14-21 shtator

Kryqi i kuq i RM-së përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq shënoi Javën e luftës kundër tuberkulozit me moton "Kërkohen: Liderë për një botë të lirë, botë pa tuberkuloz". Për këtë qëllim u realizuan një numër i madh ligjëratash edukative, punëtori, tribuna me grupe të ndryshme të synuara me një numër prej 1718 personash të pranishëm. Në fushatën Online, zbatuar nga OKKK Gazi Babë u regjistruan 213 vizitorë. Në këtë mënyrë Kryqi i kuq i RM-së kontribuoi në përpjekjet nacionale për të kontrolluar këtë sëmundje.



Shënimi i Javës së luftës kundër HIV/SIDA, 1-7 dhjetor

Në periudhën 1-7 dhjetor Kryqi i kuq i RM përmes OKKK/KKQSH shënoi javën kushtuar luftës kundër HIV/SIDA. U organizuan ngjarje të ndryshme, qoshqe në vendet më frekuentuese, ligjërata edukative, punëtori ku u dhanë prezervativë, material promovimi dhe informativ, u ndanë informacione për virusin HIV, mënyrat e transmetimit të HIV/SIDA, parandalimin dhe testimin e HIV. Në këto ngjarje morën pjesë 3058 persona të grupeve të ndryshme të synuara. Fushata që u zbatua në Prilep përfshiu 300 persona. Qëllimi i këtyre ngjarjeve ishte rritja e ndërgjegjes për parandalimin e HIV-it dhe në të njëjtën kohë uljen e stigmës lidhur me njerëzit që jetojnë me virusin HIV.

Ndryshimet klimatike – mbrojtja e shëndetit nga ndryshimet klimatike

Në muajin qershor të vitit 2018 Kryqi i kuq i RM-së së bashku me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Shëndetit Publik morën pjesë në përgatitjet për realizimin e planit të veprimit për mbrojtjen e shëndetit të popullsisë nga valët e të nxehtit me qëllim të përballimit të ndikimeve të dëmshme prej tyre. Në kuadër të mundësive të tyre organizatat komunale të Kryqit të kuq aktivizuan ekupe/vullnetarë për të ndarë ujë për popullsinë në periudhën ndërmjet orës 10 dhe 16 në ditët e valës së nxehtësisë. Aktivitetet u koordinuan me Ministrinë e Shëndetësisë, qytetin e Shkupit dhe Qendrën e Menaxhimit të Krizave. Në kuadër të aktiviteteve në terren, vullnetarë të trajnuar dhe një mjek, me automjetet e Kryqit të kuq patrulluan përgjatë lokacioneve më frekuentuese në qytetin e Shkupit, duke dhënë ujë mineral në shishe dhe flajerë, u bë matja e presionit të gjakut dhe u organizua transporti për personat në moshë dhe të sëmurët kronikë të cilët kërkuan ndihmën e ekupeve të Kryqit të kuq. Duke marrë parasysh kushtet e motit këtë verë aksioni filloi më 09 gusht dhe zgjati deri më 14 gusht të vitit 2018. Në këtë periudhë kohore një ekip me tre vullnetarë ndau 1500 shishe me ujë, respektivisht 750 litra ujë. Gjatë vikendeve u angazhuan dy ekupe vullnetarësh në Stacionet e Shpëtimit Malor Vodno dhe Matka.

Realizimi i ushtrimit të simulimit në bashkëpunim me kompaninë “Telekom”

Në muajin maj të vitit 2018, Kryqi i kuq i RM-së në bashkëpunim me kompaninë “Telekom” dhe Njësitin e Zjarri-frikësve të Qytetit të Shkupit, Ndhimën Urgjente Mjekësore dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, mori pjesë në organizimin dhe realizimin e një ushtrimi simulimi – evakuimi në një zjarr.

Ushtrimi u zhvillua në Qendrën TK të Telekomit dhe qëllimi kryesor i tij ishte parandalimi, ulja e rrezikut dhe reagimi i duhur dhe në kohë i punonjësve në një zjarr ose një aksident tjetër dhe testimi i planeve të evakuimit. Kryqi i kuq i RM-së mori pjesë me manekinët e tij që aktruan si të lënduar dhe ata ishin të grimuar për të paraqitur ushtrimin në mënyrën më realiste. Gjatë ushtrimit, punonjësit ndoqën instruksionet e përgjithshme të paraqitura në Planet e evakuimit, dhe personat e trajnuar për ofrimin e ndihmës së parë treguan shkathtësitë dhe njohuritë e marra dhe ndihmuan në kujdesin dhe evakuimin e të lënduarve.

Realizimi i trajnimeve të vullnetarëve për ofrimin e ndihmës së parë dhe paraqitjen realiste të lëndimeve

Në periudhën 17-21/22.05.2018 në Qendrën e trajnimit “Solferino” në Strugë, në kuadër të projektit të ndihmës së parë, mbështetur financiarisht nga Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe u realizua një trajnim i vullnetarëve për ofrimin e ndihmës së parë dhe paraqitjen realiste të lëndimeve (grimerë).

Në trajnimin për ndihmën e parë morën pjesë 26 pjesëmarrës, kurse në trajnimin për grimerë 27 vullnetarë të organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të Qytetit të Shkupit. Pjesëmarrësit e trajnimit për ndihmën e parë patën mundësinë për t’u njohur më afër me aktivitetet që i realizon Kryqi i kuq i RM-së veçanërisht në katastrofa dhe situata të krizës, si dhe me tema që nuk janë përfshirë në trajnimin bazik për ndihmën e parë, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të tyre dhe përsosjen e shkathtësive dhe aftësive për të ofruar ndihmën e parë në situata të ndryshme dhe për të intervenuar në kohë të duhur në lëndime në qoftë se paraqitet nevoja për këtë.

Në trajnimin për grimerë, vullnetarët patën mundësinë të njihen dhe të marrin njohuri dhe shkathtësi teorike dhe praktike për paraqitjen realiste të lëndimeve, plagëve dhe situatave të ndryshme mjekësore.

Realizimi i trajnimeve të ndihmës së parë për kandidatët për shoferë dhe personat juridikë

Organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit gjatë vitit 2018 realizuan në vazhdimësi edukime të ndihmës së parë për shoferë dhe persona juridikë. Përmes tyre janë përfshirë 15 493 kandidatët për shoferë dhe 950 persona të organizatave të ndryshme të punës.



Gara shtetërore e ndihmës së parë

Kryqi i kuq i RM-së më 22.09.2018 për herë të 27-të organizoi garën shtetërore të ndihmës së parë, dhe kësaj radhe nikoqir ishte Organizata komunale e Kryqit të kuq Kërçovë.

Në këtë garë morën pjesë 28 ekipe të rinjve të organizatave komunale të Kryqit të kuq të RM-së. Gara u zhvillua në dy trajektore garuese, A dhe B, të përbëra nga 7 baza, nga të cilat 4 të fushës së ndihmës së parë, 2 me karakter argëtues dhe 1 bazë ishte test i fushës së diseminimit. Këtë vit motoja e Garës shtetërore "Nuk ke edhe një jetë tjetër. Mëso ndihmën e parë", ishte në frymën e shënimit të Ditës Botërore të Ndhmës së Parë, kushtuar ndihmës së parë në rast aksidentesh trafiku.

Vendi i parë këtë vit u takoi vullnetarëve energjikë dhe të përgatitur shkëlqyeshëm të ekipit të OKKK Qendër, vendi i dytë i takoi ekipit të OKKK Kumanovë, ndërsa vendin e tretë e zuri ekipi i OKKK Çair.

Në kategorinë e diseminimit që gjithashtu kishte karakter garues, vendin e parë e zuri OKKK Radovish.

Ekipet më të mira morën çmime të përshtatshme si motivim për të vazhduar entuziazmin dhe kontributin e tyre në fushën e ndihmës së parë.



Shënimi i Ditës botërore të ndihmës së parë – 8 shtatori i vitit 2018

8 shtatori është Dita Botërore e Ndhmës së Parë. Këtë vit tema kryesore ishte "Fatkeqësitë në rrugë" me moton NUK KENI NEVOJË PËR NJË LICENCË PËR TË SHPËTUAR JETËN E DIKUJT! Ofrimi i ndihmës së parë në kohën dhe mënyrën e duhur për të lënduarit në aksidente trafiku mund të bëjë një dallim të rëndësishëm midis vdekjes dhe jetës. Intenca jonë është të rritet niveli i njohurive dhe shkathtësive për ofrimin e ndihmës së parë në mesin e popullsisë së përgjithshme, shoferët, këmbësorët dhe udhëtarët, në mënyrë që ata të jenë në gjendje për të ofruar ndihmën e parë për personat e lënduar në aksidente trafiku. Shkathtësitë e ofrimit të ndihmës së parë duhet të jenë në dispozicion për të gjithë si një akt humanitar që autorizon njerëzit për të shpëtuar jetë dhe për të ndihmuar në shërimin e sëmundjeve ose lëndimeve që ndodhin papritmas. Për këto arsye, Kryqi i kuq i RM-së angazhohet që të paktën një anëtar i çdo familjeje të edukohet dhe të aftësohet për të ofruar ndihmën e parë.



Java botërore për përdorimin racional të antibiotikëve

Me rastin e Javës Botërore për Përdorimin Racional të Antibiotikëve 2018, Zyra Rajonale e OBSH-së për Evropën bashkoi forcat me Zyrën Rajonale për Ushqimin dhe Bujqësinë të Kombeve të Bashkuara (FAO) për Evropën dhe Azinë Qendrore dhe Organizatën Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OIE) – Përfaqësia rajonale për Azinë Qendrore të ftojë qeveritë të përdorin qasjen Një Shëndetësi. Republika e Maqedonisë u është bashkuar përpjekjeve ndërkombëtare për qasjen në "Një Shëndetësi".

Nikoqir i ngjarjes ishte Kryqi i kuq i RM-së. Ngjarja qendrore u mbajt më 19 nëntor në orën 12 në ambientet e Dare Xhambaz, në frymën e NJË SHËNDETËSIE, një takim i përbashkët midis dy sektorëve - shëndetësisë, kryesisht kujdesit parësor shëndetësor, dhe mjekësisë veterinarë. Në të cilën u shkëmbyen përvojat dhe gjendja me AMR-në në të dy sektorët dhe do të ofrohen udhëzime për aktivitetet e ardhshme. Në emër të Ministrisë së Shëndetësisë ngjarjen e hapi Dr. Vladimir Milloshev, Sekretar shtetëror.

Qasja "Një Shëndetësi" përfshin veprim në sektorët e shëndetit të njeriut, kafshëve dhe mjedisit jetësor. Duhet të jemi të vetëdijshëm se bakteret rezistuese, kërpudhat, viruset dhe parazitët nuk dinë për kufij, dhe sektorë të ndryshëm, si shëndeti publik, shëndeti veterinar dhe shëndeti i mjedisit jetësor, duhet të bashkohen në procesin e kontrollit të këtij problemi të rëndësishëm.

DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë dhe Instituti i Mjekësisë së Transfuzionit në vitin 2018, nga 55.000 njësi të planifikuara të gjakut realizuan 57.033 njësi gjaku ose detyrimet e planit i përmbushën për 103.70 %. Për dallim të vitit 2017 kur u realizuan 55.537 njësi të gjakut u shënuan rezultate më të mira për 1.496 njësi të gjakut.

Në qytetin e Shkupit, organizatat komunale të Kryqit të kuq Gazi Babë, Karposh, Kisella Vodë, Qendër dhe Çair, në vitin 2018 realizuan 20.206 njësi gjaku ose përmbushën detyrimet e planit për 129.25 %, që në krahasim me vitin 2017, kur u realizuan 20.062 njësi gjaku, shënuan rezultate më të mira për 144 njësi gjaku.

Në organizatat komunale të Kryqit të kuq të brendisë së vendit tonë, në vitin 2018 u realizuan 36.827 njësi gjaku ose krahasuar me vitin 2017 kur u realizuan 35.494 njësi gjaku, u shënuan rezultate më të mira për 1.333 njësi gjaku.

Në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit "8 Shtatori" në Shkup, në shërbimin e mjekësisë së transfuzionit në vitin 2018 u realizuan 2.124 njësi gjaku dhe krahasuar me vitin 2017 kur u realizuan 2.108 njësi gjaku u shënuan rezultate më të mira për 16 njësi gjaku.

Në Qendrën ditore të dhurimit të gjakut në SHOH "Dare Xhambaz" në Shkup, në vitin 2018 u realizuan 2.286 njësi gjaku prej të cilave 2.048 me vetiniciativën e qytetarëve të Shkupit, ndërkaq përmes aksioneve të organizuara të dhurimit të gjakut u mblodhën 238 njësi gjaku. Në krahasim me vitin 2017 kur u mblodhën gjithsej 2.018 njësi gjaku, u shënuan rezultate më të mira për 268 njësi gjaku.

Detyrimet e planit për dhurimin e gjakut në vitin 2018 i përmbushën 17 organizata komunale, siç janë: Manastir 101.96 %, Vallandovë 106.72%, Veles 242.83 %, Vinicë 238.77 %, Dellçevë 103.70 %, Kavadar 154.64 %, Kriva Pallankë 120.10 %, Krushevë 111.79 %, Negotinë 117.12 %, Probishtip 155.63 %, Sveti Nikollë 203.96 %, Strugë 130.96 %, Shtip 167.76 %, Gazi Babë 157.81 %, Karposh 105.60 %, Qendër 231.07 % dhe Çair 107.02 %. Përparim më të mirë në shënimin e rezultateve në dhurimin e gjakut në Maqedoni në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 shënoi OKKK Probishtip.

Ekipi i koordinimit gjatë vitit 2018 mbajti 118 takime koordinimi dhe koordinoi 748 aksione të dhurimit të gjakut në terren.

U shënuar 17 marsi, Dita e dhurimit të gjakut në R. e Maqedonisë

Ngjarja solemne me rastin e 17 marsit – Ditës së themelimit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Ditës së dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë u mbajt më 16 mars të vitit 2018 në sallën Square 21 në Shkup. Në këtë ngjarje fjalim rasti para të pranishmëve pati Kryetari i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, Prof. Dr. Romel Velev i cili u bëri një vështrim rolit, detyrave dhe qëllimeve të Organizatës. Gjithashtu të pranishmëve ju drejtuan Ministri i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë Dr. Venko Filipçe dhe Drejtori i Institutit të Mjekësisë së Transfuzionit Prof. Koço Dimitrovski. Me rastin e 17 marsit, Ditës së dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë, në shumë OKKK dhe KKQSH u organizuan ngjarje solemne ku u dhanë mirënjohje jubilarë (distinktivë, pllaka, falënderime dhe dhurata) për organizatat e dalluara dhe dhuruesit e shumëfishtë të gjakut. Në ngjarjen solemne që u organizua nga Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë, Ministri i Shëndetësisë, Dr. Venko Filipçe, dha pllaka dhe çmime në të holla për tri organizatat komunale të Kryqit të kuq, Qendër, Veles dhe Vinicë, të cilat ishin më të suksesshmet ndër 18 OKKK-të që përmbushën planin e dhurimit të gjakut në vitin 2017.



Educational forms for voluntary blood donation

Organizuar nga Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë dhe Institutit të Mjekësisë së Transfuzionit, në periudhën nga 29 qershori deri më 01 korrik të vitit 2018 në Strugë u zhvillua punëtorja e edukimit të motivuesve të rinj për dhurim vullnetar të gjakut ku morën pjesë 27 pjesëmarrës të organizatave komunale të Kryqit të kuq Gazi Babë, Qendër, Çair, Kisella Vodë, Karposh, Tetovë, Gostivar, Veles, Negotinë, Strumicë, Koçanë dhe Ohër, përfaqësues të ARM-së dhe mysafirë nga Kryqi i kuq i Novi Sadit. Qëllimi kryesor i punëtorisë ishte edukimi i motivuesve të rinj për dhurim vullnetar të gjakut të cilët do të aftësohen për përfshirje të mëtejshme në procesin e dhurimit të gjakut për organizimin e aksioneve të dhurimit të gjakut në mjediset e tyre dhe në nivel komunal. Përmbajtjet e programit u prezantuan në bazë të parimeve të mësimin për të rritur përmes prezantimeve, ndarjes së përvojave, luajtjes së roleve, ushtrimeve dhe mundësive për pjesëmarrje aktive të pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit e punëtorisë sollën disa përfundime: realizimin e suksesshëm të Programit për organizimin dhe përparimin e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë nga ana e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Institutit të Mjekësisë së Transfuzionit, zhvillimin dhe përparimin e një programi afereze për dhurimin e trombociteve, realizimin e një Plani operativ për rritjen e numrit të dhurimit të gjakut tek komuniteti etnik i shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë dhe angazhimi për realizimin e privilegjeve ligjore për dhuruesit e gjakut.

Organizuar nga Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë dhe Instituti i Mjekësisë së Transfuzionit, në periudhën 02-04 nëntor të vitit 2018 në Strugë u zhvillua punëtorja për motivimin dhe përparimin e dhurimit vullnetar të gjakut në R. e Maqedonisë. Në këtë punëtori morën pjesë 38 pjesëmarrës, si, motivues të rinj të përfaqësuar përmes Klubit 25 të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, motivues të Klubit të dhuruesve të gjakut të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, persona të punësuar si profesionistë në Institutin e Mjekësisë së Transfuzionit dhe mysafirë të Kryqit të kuq të Shqipërisë. Qëllimet kryesore të punëtorisë ishin edukimi, motivimi dhe përparimi i dhurimit vullnetar të gjakut në R. e Maqedonisë, tërheqja e dhuruesve të rinj dhe të atyre që dhurojnë për herë të parë, zhvillimi i programit për dhurimin aferezë të trombociteve dhe rritja e numrit të dhuruesve të gjakut tek popullsia shqiptare. Punëtorinë e vizituan dhe të pranishmëve iu drejtuan Sekretari i përgjithshëm i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë Dr. Sait Saiti, Drejtori i Institutit të Mjekësisë së Transfuzionit Dr. Sedulla Useini dhe udhëheqësi i departamentit të planifikimit, organizimit dhe koleksionimit të ITM-së Dr. Goran Andonov. Në punëtori përmes punës në tri grupe (motivues të rinj, motivues të kompanive dhe institucioneve dhe motivues të popullsisë shqiptare) u punua në dy tema: "Motivimi dhe demotivimi në dhurimin e gjakut – ndarja e përvojave" dhe "Çfarë mund të ndryshojmë, përmirësojmë, çfarë më tej... përfundime". Pas përfundimit të ushtrimeve praktike vijoi evalvimi i grupeve punuese përmes sesioneve.



U zhvilluan lojëra sportive-rekreative të dhuruesve të gjakut

Organizuar nga Klubi i dhuruesve të gjakut të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit në periudhën 04-06 maj të vitit 2018 në Hotelin e MPB-së në Krani – Prespë u mbajtën Lojërat sportive-rekreative tradicionale të dhuruesve të gjakut për herë të 10-të me radhë. Në këto lojëra morën pjesë shtatë ekipe me mbi 130 garues, si vijon: Klubi i dhuruesve të gjakut të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, SHA Rafineria OKTA, SHA Makpetrol, SHA Banka Komerciale, JSP – Shkup, Bargalla – Shtip dhe ARM-ja. Ekipet garuan në këto disiplina për burra dhe gra: vrapim në 50 metra, vrapim në thasë në 25 metra, kërcim në largësi nga vendi, hedhja e gjyles, ping-pong, pikado, shah, gjuajtja treshe në kosh dhe tërheqja ekipore e litarit. Vendin e parë në konkurrencën ekipore me 39 pikë e zuri ekipi i JSP – Shkup, vendin e dytë me 33 pikë të fituara e ndanë ekipet e SHA Makpetrol dhe Bargalla – Shtip, dhe vijuan ekipet e SHA Banka Komerciale me 23 pikë, ARM-ja me 12 pikë, SHA Rafineria OKTA me 9 pikë dhe Klubi i dhuruesve të gjakut të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit me 4 pikë. Ekipi ngadhënjyes i garave mori një trofe, ndërsa falënderime u ndanë në të gjitha disiplinat për plasmanin në vendin I, II dhe III.

U shënua 14 qershori, Dita botërore e dhurimit të gjakut

Më 14 qershor të vitit 2018 u shënua Dita botërore e dhurimit të gjakut. Ngjarja kryesore u mbajt në Qendrën ditore të dhurimit të gjakut në SHOH "Dare Xhambaz" në Shkup. Fjalë përshëndetëse tha Sekretarja e KKQSH, z-jë Suzana Tuneva Paunovska. Para të pranishmëve foli Kryetari i qytetit të Shkupit z. Petre Shilegov i cili vuri theksin në mbështetjen e qytetit të Shkupit për iniciativën e hapjes së Qendrës ditore për dhurimin e gjakut dhe aktivitetet e lidhura me dhurimin vullnetar të gjakut. Në këtë ngjarje foli edhe Sekretari shtetëror i Ministrisë së Shëndetësisë Dr. Vladimir Milloshev. U ndanë pllaka dhe falënderime për organizata, institucione dhe kompani për kontributin e tyre në procesin e promovimit të përparimit të dhurimit të gjakut në territorin e qytetit të Shkupit. Për punën 5-vjeçare në Qendrën ditore të dhurimit të gjakut me pllaka u shpërblyen SHA Alkaloid dhe Kuvendi i qytetit të Shkupit, ndërsa falënderime morën Moto-klubi "Potfat MC", Moto-klubi "Gardian Enxhells", Drejtorja e Të Ardhurave Publike e RM-së, Rade Konçar – kontaktorë dhe relejë, Agjencia e Kadastrës dhe Patundshmërive e RM-së, Lidhja e Skautëve të Maqedonisë dhe Sigurimi Sava. Deklaratë për mediat dhanë Drejtori i Institutit të Mjekësisë së Transfuzionit Dr. Sadulla Useini dhe Sekretari shtetëror i Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Maqedonisë Dr. Vladimir Milloshev.



MOBILIZIMI I FONDEVE NGA SEKTORI I KORPORATAVE

Bashkëpunimi me sektorin e korporatave dhe vendosja e partneriteteve strategjike me kompanitë është një nga angazhimet parësore të shoqatave nacionale për të siguruar mbështetjen e aktiviteteve të programeve dhe projekteve. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë vitin e fundit realizoi bashkëpunim me kompani të rëndësishme të vendit që praktikojnë punë të përgjegjshme shoqërore, të cilat sigurojnë mbështetjen e aktiviteteve për grupe të ndryshme të synuara të popullsisë në komunitete. Gjatë vitit u bë implementimi i iniciativave të përbashkëta të Kryqit të kuq dhe kompanive të cilat përveç qëllimit të caktuar humanitar ishin edhe inkurajim për përfshirjen e punonjësve të kompanive, të cilët përmes tyre treguan përgjegjësinë sociale. Ata së bashku me vullnetarët dhe punonjësit e Kryqit të kuq ishin pjesë e implementimit të aksioneve humanitare.

Gjatë vitit 2018, aktivitetet e projektit dhe programit të Kryqit të kuq të RM-së në vlerë prej gjithsej 1.700.000 denarë u mbështetën nga kompanitë Banka Komerciale, Banka Shparkase, Vezë Sharri, Vitalia, Fondacioni Telekom i Maqedonisë, VIP etj.

Kryqi i kuq i RM-së gjatë vitit realizoi bashkëpunim me odat ekonomike të vendit të cilat mundësuan mbështetjen e anëtarëve të tyre për implementimin e aktiviteteve humanitare të Kryqit të kuq.

Takimi i partneritetit i Kryqit të kuq të RM-së

Më 19 dhjetor të vitit 2018 Kryqi i kuq i RM-së organizoi Takimin e partneritetit me qëllim të promovimit të vlerave dhe kapaciteteve humanitare të Kryqit të kuq për inkurajimin e partneriteteve strategjike për implementimin e iniciativave shoqërore të përbashkëta për përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë së prekshme. Në këtë ngjarje folën – Sekretari i përgjithshëm i Kryqit të kuq të RM-së në temën: “Bashkëpunimi i partneritetit në mes Kryqit të kuq dhe sektorit të korporatave”; një përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale: “Kontributi për përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë së prekshme përmes bashkëpunimit të partneritetit në mes institucioneve, shoqatave civile dhe sektorit të korporatave”, kryetarë/përfaqësues të odave ekono-

mike të RM-së, Lidhja e Odave Ekonomike të RM-së dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore në temën: “Përmes përgjegjësisë shoqërore për një investim të përbashkët në komunitetet”.

Në takimin e partneritetit u dhanë mirënjohjet e mëposhtme të Kryqit të kuq të RM-së për kompanitë që sigurojnë mbështetjen për implementimin e aktiviteteve të projektit të Kryqit të kuq: “Mbështetësi i Platinit” për kompanitë Banka Prokredit SHA Shkup dhe Banka Komerciale SHA Shkup, “Mbështetësi i Artë” për Bankën Shparkase Maqedonia SHA Shkup dhe “Mbështetësi i Bronztë” për kompaninë “Vezë Sharri”. Fituesit shprehën falënderimin për mirënjohjet dhe interesimin e tyre për një bashkëpunim të mëtejshëm të frytshëm me Kryqin e kuq.



RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2018

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë punën e tij e paraqet përmes raportit financiar i cili përmban të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara dhe të realizuara. Raporti financiar është një konfirmim i implementimit të suksesshëm të aktiviteteve të programit dhe projektit të mbështetura nga partnerë vendorë dhe të huaj të organizatës.

Puna e organizatës e prezantuar përmes të dhënave financiare tregon një vit të përfunduar me sukses me realizim të Buxhetit prej 130,74%, për dallim nga viti 2017 kur realizimi ishte 92,08%. Të ardhurat e veta janë realizuar me 117,12% dhe marrin pjesë me 18,79% në realizimin e të ardhurave të përgjithshme. Të ardhurat nga organet dhe donatorët janë të ardhura të dedikuara të cilat në pjesën më të madhe transferohen në organizatat komunale, kur përdoren për implementimin e aktiviteteve të projektit. Këto të ardhura janë realizuar me 134,36% dhe shënojnë rritje në krahasim me vitin 2017 kur u realizuan 88,38%. Ato përfshijnë 81,21% të të ardhurave të realizuara përgjithësisht në vitin 2018.

Në pjesën e shpenzimeve mund të verifikohet se shpenzimi është i kontrolluar dhe i dedikuar, që është qëllim kryesor i çdo organizate. Nga realizimi i të ardhurave të përgjithshme, shpenzimet funksionale respektivisht programore janë rritur në krahasim me vitin paraprak dhe shënojnë 75,66%, shpenzimet për pagën e punonjësve janë 11,17%, dhe shpenzimet materiale janë 13,18%. Nga shpenzimet e realizuara përgjithësisht 22,51% kanë të bëjnë me nevojat e zyrës qendrore dhe shënojnë rritje në krahasim me vitin e kaluar, 44,64% direkt janë transferuar në organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, ndërsa të tjerat 32,85% janë mjete që janë shpenzuar në zyrën qendrore dhe i referohen realizimit të aktiviteteve programore të organizatave komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit.

Një pjesë e teprcës së mjeteve financiare respektivisht dallimi pozitiv midis të ardhurave dhe shpenzimeve janë mjete të dedikuara që kanë të bëjnë me projekte që vazhdojnë të realizohen në vitin 2019.

Këshilli udhëheqës i Kryqit të kuq të RM-së formoi një komision, i cili bëri kontrollin e brendshëm të punës financiare dhe materiale. Gjithashtu u angazhua një shtëpi e pavarur e revizionit, e cila kreu revizionin në përputhje me Ligjin e Revizionit dhe Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe dispozitave të kontabilitetit që janë në fuqi në Republikën e Maqedonisë. Sipas mendimit të Shtëpisë së revizionit, gjendja financiare e organizatës së Kryqit të kuq të RM-së është paraqitur në mënyrë reale dhe objektive.

Raporti financiar ka të bëjë vetëm me punën e zyrës qendrore të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.



RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2018

		Buxheti 2018		Realizuar 2018		%	% në 2017
TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME		78,586,353.00		102,744,807.00		130.74	92.08
Burimet e veta të të ardhurave		16,484,800.00		19,307,619.00		117.12	123.15
Të ardhurat nga organet/donatorët		62,101,553.00		83,437,188.00		134.36	88.38
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME		78,586,353.00		85,539,383.00		108.85	79.01
Rrogat dhe kompensimet për punonjësit		10,364,416.00		9,550,898.00		92.15	96.98
Shpenzimet për materialet dhe shërbimet		7,210,456.00		11,269,893.00		156.30	124.20
Shpenzimet funksionale (programore)		61,011,481.00		64,718,592.00		106.08	74.76
DALLIMI		0.00		17,205,424.00			
TË ARDHURAT							
PËRSHKRIMI		Burimet e veta të të ardhurave	Të ardhurat nga organet/donatorët	"Buxheti 2018"	Realizuar nga burimet e veta	Realizuar nga organet dhe donatorët	"Realizuar 2018"
74	TRANSFERET DHE DONACIONET						
741	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	6,000,000.00		6,000,000.00	6,000,000.00		6,000,000.00
741	Dhurimi i gjakut (Ministria e Shëndetësisë)		6,458,500.00	6,458,500.00		7,017,079.00	7,017,079.00
742	Veprimtaria sociale-humanitare	200,000.00	4,750,000.00	4,950,000.00	611,645.00	13,096,112.00	13,707,757.00
742	Organizimi dhe zhvillimi		31,072,000.00	31,072,000.00	12,600.00	540,760.00	1,152,405.00
742	Ndihma e parë	2,500,000.00		2,500,000.00	3,018,300.00	445,588.00	3,463,888.00
742	Edukata shëndetësore		5,277,688.00	5,277,688.00		3,460,991.00	3,460,991.00
742	Rinia	336,000.00		336,000.00	121,395.00	987,262.00	1,108,657.00
742	Katastrofat		2,099,565.00	2,099,565.00	29,000.00	24,697,866.00	24,726,866.00
742	Diseminimi		756,120.00	756,120.00			0.00
742	KK në aksion - PVH		300,000.00	300,000.00		423,000.00	423,000.00
742	Informimi dhe komunikimi		448,000.00	448,000.00			0.00
742	Shërbimi për kërkesa		939,680.00	939,680.00		1,202,052.00	1,202,052.00
742	Reparti ndërkombëtar/bashkëpunimi ndërkombëtar			0.00			0.00
742	Mobilizimi i fondeve			0.00			0.00
742	Financat (të ardhurat tjera)/kreditë për veturë/ndaljet për punonjësit, interesi/			0.00	1,272,826.00		1,272,826.00
72	TË ARDHURAT JO-TATIMORE						0.00
725	Nga OKKK (në bazë të kotizacionit)	1,180,000.00		1,180,000.00	1,809,283.00		1,809,283.00
725	Donacionet nga personat fizikë	300,000.00		300,000.00	15,000.00	11,355.00	26,355.00
725	Donacionet nga personat juridikë/ Shitja e veturave	500,000.00		500,000.00		16,698.00	16,698.00
725	Pullat postare shtesë (nga Ligji i KK)	300,000.00		300,000.00	211,228.00		211,228.00
723	Nga dhënia me qira e hapësirës afariste/të ardhura të tjera/ të ardhura nga shitja e mjeteve kapitale	1,918,800.00		1,918,800.00	2,193,330.00		2,193,330.00
725	Nga regjistrimi i automjeteve	1,180,000.00	10,000,000.00	11,180,000.00	495,597.00	9,907,590.00	10,403,187.00
725	Të ardhurat tjera/ të ardhurat nga interesi/Fondi i solidaritetit /Fondi i zhvillimit/PVH	70,000.00		70,000.00	3,517,415.00		3,517,415.00
725	Të ardhurat e transferuara nga viti i mëparshëm	2,000,000.00		2,000,000.00		21,630,835.00	21,630,835.00
TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME		16,484,800.00	62,101,553.00	78,586,353.00	19,307,619.00	83,437,188.00	102,744,807.00



SHPENZIMET PËRSHKRIMI		Nga burimet e veta	Nga organet dhe donatorët	Buxheti 2018	Realizuar nga burimet e veta	Realizuar nga organet dhe donatorët	Realizuar 2018
SHPENZIMET AKTUALE							
401	RROGAT DHE KOMPENSIMET BAZË	7,494,036.00	2,840,380.00	10,334,416.00	7,136,102.00	2,358,638.00	9,494,740.00
402	KONTRIBUTET NGA RROGAT DHE TATIMI PERSONAL	30,000.00	0.00	30,000.00	41,847.00	14,311.00	56,158.00
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME PËR RROGA		7,524,036.00	2,840,380.00	10,364,416.00	7,177,949.00	2,372,949.00	9,550,898.00
420	SHPENZIMET RRUGORE DHE DITORE	70,000.00	0.00	70,000.00	339,505.00	753,128.00	1,092,633.00
421	SHËRBIMET KOMUNALE	860,000.00	0.00	860,000.00	341,675.00	724,557.00	1,066,232.00
422	NGROHJA	480,000.00	0.00	480,000.00	279,836.00	11,535.00	291,371.00
423	KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI	1,780,000.00	763,320.00	2,543,320.00	1,066,513.00	1,927,803.00	2,994,316.00
423	MATERIALET	1,176,000.00	3,487,863.00	4,663,863.00	2,152,621.00	2,562,313.00	4,714,934.00
424	MIRËMBAJTJA E VAZHDUESHME	962,000.00	0.00	962,000.00	549,167.00	357,338.00	906,505.00
425	SHËRBIMET E KONTRAKTUARA	3,849,456.00	12,533,058.00	16,382,514.00	4,595,918.00	13,262,870.00	17,858,788.00
426	SHPENZIMET TJERA OPERATIVE	400,000.00	0.00	400,000.00	260,847.00	190,208.00	451,055.00
463	TRANSFERET NGA ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE	0.00	19,648,000.00	19,648,000.00	0.00	38,188,552.00	38,188,552.00
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME TË VAZHDUESHME		17,101,492.00	39,272,621.00	56,374,113.00	16,764,031.00	60,351,253.00	77,115,284.00
SHPENZIMET KAPITALE							
483	BLERJA E MOBILEVE DHE PAJISJEVE TË ZYRËS	0.00	812,240.00	812,240.00	1,272,491.00	227,247.00	1,499,738.00
483	BLERJA E AUTOMJETEVE	0.00	0.00	0.00	1,464,660.00	0.00	1,464,660.00
481	MIRËMBAJTJA BAZË DHE SPECIALE	400,000.00	0.00	400,000.00	281,477.00	25,000.00	306,477.00
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME KAPITALE		400,000.00	812,240.00	1,212,240.00	3,018,628.00	252,247.00	3,270,875.00
NDIHMA, DONACIONE DHE TATIME TË TJERA		0.00	21,000,000.00	21,000,000.00	0.00	5,153,224.00	5,153,224.00
GJITHSEJ NDIHMA, DONACIONE DHE TATIME TË TJERA		0.00	21,000,000.00	21,000,000.00	0.00	5,153,224.00	5,153,224.00
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME		17,501,492.00	61,084,861.00	78,586,353.00	19,782,659.00	65,756,724.00	85,539,383.00

Shërbimi Financiar
Zhaklina Popoviq



Sekretari i Përgjithshëm
Dr. Sait Saiti

		%
transferet në OKKK	38,188,552.00	44.64
shpenzimet për zyrën qendrore	19,254,949.00	22.51
shpenzimet e zyrës qendrore për OKKK-të	28,095,882.00	32.85
	85,539,383.00	100.00

TË HYRAT E PËRGJITSHME TË REALIZURA NË VITIN 2018



TË DALURA NË VITIN 2018



RAPORTI I REVIZORIT TË PAVARUR

Për:

Udhëheqjen e

KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

SHKUP

Ne kemi kryer revizionin e raporteve financiare të bashkëngjitura të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" (në tekstin e mëtejme Organizata), të cilat përfshijnë Bilancin e gjendjes së ditës 31 dhjetor të vitit 2018, si dhe Bilancin e të hyrave dhe shpenzimeve dhe Raportin për ndryshimet në fondin afarist për vitin që përfundon në atë ditë dhe pasqyrën e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Raportet e bashkëngjitura financiare për vitin 2018 përbëhen nga raportet për punën e rregullt të Organizatës si dhe raportet për projektet: Fushata për HIV/SIDA: Kryqi i kuq i Austrisë (Ndihma e parë psikologjike dhe mbështetja psikosociale në situata emergjente); Fondi global për mirëmbajtjen e prevalencës së ulët të HIV/SIDA në RM; Federata ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe; Marrja e aksionit për përfshirjen sociale të personave të moshuar; Promovimi i vlerave humane; Kryqi i kuq i Gjermanisë; Konkurrenca në tregun e punës dhe raportet për të dy fondet: 1) Fondi i zhvillimit dhe 2) Fondi i solidaritetit; Parandalimi i HIV tek LID; Krijimi i mundësive për punësim të reja të grave, si dhe llogaria për donacionet nëpërmjet rrugës elektronike, Fushata HIV/SIDA dhe Fondi për reagim emergjent në katastrofa. Projektet janë financuar nga donatorë të veçantë dhe ato janë realizuar përmes nën-llogarive speciale (të dedikuara) të Organizatës. Për to Organizata nuk përgatit raporte speciale financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit për raportet financiare

Menaxhmenti i Organizatës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të këtyre raporteve financiare në përputhje me Ligjin e kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse dhe standardet për raportimin financiar në bazë të parasë së gatshme. Kjo përgjegjësi përfshin: formësimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm që është relevant në përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare që janë të lira nga gabimet materiale, pa marrë parasysh nëse janë rezultat i mashtrimit ose gabimit, zgjedhjen dhe aplikimin e politikave adekuate të kontabilitetit, si dhe bërjen e vlerësimeve të kontabilitetit që janë të arsyeshme në rrethanat.

Përgjegjësia e revizorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim mendim për këto raporte financiare në bazë të revizionit tonë. Revizionin e zbatuam në përputhje me Standardet ndërkombëtare të revizionit. Këto standarde kërkojnë të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë revizionin për të marrë një bindje të arsyeshme për atë nëse raportet financiare janë të lira nga gabimet materiale.

Revizioni përfshin kryerjen e procedurave për marrjen e dëshmive revizore për shumat dhe informacionet e dhëna në raportet financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i revizorit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve nga gabimet materiale të raporteve financiare, pa marrë parasysh nëse është rezultat i një mashtrimi dhe gabimi. Kur i bën këto vlerësime të rrezikut, revizori shqyrton kontrollin e brendshëm që është relevant për përgatitjen dhe prezantimin objektiv të raporteve financiare për të formësuar procedura të revidimit që janë adekuate me rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së mendimit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Revizioni gjithashtu përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyetimin e vlerësimeve të kontabilitetit të bëra nga ana e menaxhmentit, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të raporteve financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e revizionit që i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për mendimin tonë të revizionit.

Mendimi i revizorit

Sipas mendimit tonë, raportet shoqëruese financiare të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË" paraqesin në mënyrë reale dhe objektive të gjitha aspektet e rëndësishme, gjendjen financiare të Organizatës më datë 31 dhjetor të vitit 2018, si dhe rezultatet e punës së saj dhe ndryshimet në fondet për vitet që përfundojnë në atë ditë, në përputhje me Ligjin e kontabilitetit për organizatat jofitimprurëse dhe standardet për raportimin financiar në bazë të parave të gatshme.

Raporti për kërkesat tjera juridike dhe rregullative

Menaxhmenti i Organizatës gjithashtu është përgjegjës për përgatitjen e raportit vjetor të punës në përputhje me Ligjin e shoqatave dhe fondacioneve. Përgjegjësia jonë në përputhje me Ligjin e revizionit është të njoftojmë nëse raportit vjetor i punës është në pajtim me llogarinë vjetore dhe raportet financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor të vitit 2018. Puna jonë në lidhje me raportin vjetor të punës është kryer në përputhje me MSR 720 dhe është kufizuar në njoftimin nëse informacionet historike financiare të paraqitura në raportin vjetor të punës janë në pajtim me llogarinë vjetore dhe raportet e reviduara financiare.

Raporti vjetor i punës është në pajtim, në të gjitha aspektet materiale, me llogarinë vjetore dhe raportet e reviduara financiare të "KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË", Shkup, për vitin që përfundon më 31 dhjetor të vitit 2018.

Shkup, 28 shkurt i vitit 2019

Menaxher
Dragan Dimitrov



Revizor i autorizuar
Zvonko Kočovski



TABLE OF CONTENTS:

INTRODUCTION	91
ORGANIZATIONAL DEVELOPMENT OF THE NATIONAL SOCIETY AND INTERNATIONAL PARTNERSHIP COOPERATION	92
TRANSPARENT IN FRONT OF THE PUBLIC.....	96
DISSEMINATION	97
PROMOTION OF HUMAN VALUES.....	100
VOLUNTEER MANAGEMENT	102
YOUTH ACTIVITIES	103
DISASTER PREPAREDNESS AND RESPONSE.....	106
TRACING SERVICE - RESTORING FAMILY LINKS.....	113
SOCIAL WELFARE ACTIVITIES.....	115
HEALTH PREVENTIVE ACTIVITIES.....	121
BLOOD DONATION.....	124
MOBILIZATION OF FUNDS FROM THE CORPORATE SECTOR	127
FINANCE REPORT FOR 2018	128
AUDITOR'S REPORT.....	132

INTRODUCTION

Another year is behind us. A year marked by the hard work of our volunteers and staff. We were together with our partners. Our partners from the International Red Cross and Red Crescent Movement, which enabled us to implement all our ideas, particularly to meet the essential needs of the migrant population and to build the capacities of our national society.

Also, we must emphasize the support of the authorities in the state provided on national and local level. We implemented joint projects for different target groups of population, in accordance with the provision of the Geneva Conventions related to the auxiliary role of our organization. Together we were stronger and complemented each other and we fulfilled the expectations of the population in the Republic of Macedonia. We worked on promotion of the normative framework to ensure better preconditions for more successful operation.

We must stress the successful cooperation with the UN agencies and the cooperation with the European Union on project implemented with international and local partners. This cooperation helped us to build our capacities and to implement activities in the local communities on basis of the needs of the target beneficiaries that we serve. We also learned a lot from this projects. With great pleasure we learn and we are always prepared to share good practices in order to be more successful in the implementation of our tasks and responsibilities in accordance with the Red Cross mandate.

We marked a successful year in the cooperation with the corporate sector. We are always prepared for initiatives that build bridges between business entities and our final beneficiaries.

We implemented different projects and we delivered services for the senior citizens, for the youngest, for persons exposed to different health and social risks, we promoted volunteering, we disseminated international humanitarian law and the work of the Red Cross, we assisted migrants, homeless people, we thought people how to properly administer first aid, we promoted blood donation, we collected and distributed humanitarian assistance, we provided psychological support, we conducted trainings on water safety and mountain rescue, we raised the awareness of the population on protection from different diseases and disaster preparedness and response, we conducted numerous trainings on peer education for the youth, and we gave our modest contribution in international frameworks.

Gratitude to all our volunteers, partners, supporters, donors and staff for the support and the engagement. With you the Red Cross will always be what it is. A hope for better and happier tomorrow for many people in the world.


PhD Sait Saiti
Secretary General


Prof. Dr. Romel Velez
President

ORGANIZATIONAL DEVELOPMENT OF THE NATIONAL SOCIETY AND INTERNATIONAL PARTNERSHIP COOPERATION

